



DASH: KORRUPSIONI QEVERITAR DHE DHUNA ME BAZË GJINORE, NDËR PROBLEMET KYÇE NË KOSOVË

FAQE 4-5




Departamenti Amerikan i Shtetit thotë se çështjet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë vitit të kaluar ishin korrupsioni serioz i qeverisjes dhe

mosndëshkimi i tij, mungesa e hetimit dhe përgjegjësisë për dhunën me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje ose nga partnerët, dhunën seksuale dhe

forma të tjera të kësaj dhune, dhe krime që përfshijnë dhunë ose kërcënime për dhunë ndaj pakicave etnike ose komuniteteve të tjera të marginalizuara

KURTI: SERBIA TË DËNOHET PËR MOSNËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES

FAQE 3



OSMANI I KËRKON PRESIDENTIT TË IZRAELIT
MBËSHETJE PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS
NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE | FAQE 7

OPINION

HAGË, HESHTJA
E FRIKSHME
PËRBALLË
SPECIALES F. 6

Shkruan:
Arben AHMETI



AKTUALE



BOMBARDUESIT RUSË
FLUTUROJNË AFËR JAPONISË F. 2

BOSCH: GJYQARËT E SPECIALES
PO MARRIN PAGA TË MAJME
NË KURRIZ TË TË PANDEHURVE,
PSE NUK I LEJONI TË SHKOJNË
NË SHTËPI? F. 6

EKONOMI



BQK-ja SHËNON FILLIMIN E
AKTIVITETEVE TË JAVËS
NDËRKOMBËTARE TË PARASË F. 8

SPORT



ADEMI: TA JETËSOJMË
ËNDRRËN E KUALIFIKIMIT
NË KAMPIONATIN EVROPIAN F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fac: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kurti: Serbia të dënohet për mosnënshkrimin e marrëveshjes

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se faktorët ndërkombëtarë duhet ta "dënojnë" Serbinë, e cila, sipas tij, ka refuzuar ta nënshkruajë aneksin për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve mes dy shteteve. Gjatë një prononcimi për gazetaret në Prishtinë të martën, Kurti ka thënë se për Kosovën marrëveshja bazë dhe aneksi i zbatimit të saj janë "marrëveshje", pavarësisht se më 18 mars Serbia nuk pranoi ta nënshkruajë.

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara thanë se, pavarësisht që kjo marrëveshje nuk u nënshkrua nga palët, ato e konsiderojnë atë si të tillë. "Edhe marrëveshjen bazë dhe planin e zbatimit tashmë i kemi të dakorduara. Për ne kjo është marrëveshje, por unë pres nga faktorët ndërkombëtarë që ta gjykojnë, ta dënojnë sjelljen e Serbisë e cila, kur zhvillohen takime, thotë 'nuk nënshkruaj', e ndërmjet takimeve thotë 'nuk zbatoj gjë'", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se marrëveshja bazë është njohje de facto. "Nuk mund të flasë kështu pala tjetër kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Kombet e Bashkuara. Nuk mund të flasë se si kurrë nuk do ta njohë Kosovën meqenëse marrëveshja bazë është njohje de facto. Pra, unë

besoj se kjo është thelbësore për procesin dhe është e rëndësishme që të gjithë partnerët, aleatët, miqtë tanë të vendeve demokratike në Perëndim, dhe jo vetëm, të vazhdojnë të qëndrojnë pranë Kosovës kur ne jemi konstruktivë, të përkushtuar e kreativë si asnjëherë", ka thënë ai. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se nuk e ka nënshkruar marrëveshjen, "sepse Serbia është shtet i njohur ndërkombëtarisht, ndërsa Kosova nuk është" prandaj, sipas tij, nuk mund të arrihet një marrëveshje juridike ndërkombëtare.

Në Ohër, më 18 mars, Kurti, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, u pajtua me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, për aneksin e zbatimit të marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve.

Për këtë marrëveshje palët ishin dakorduar në fund të shkurtit. Kjo marrëveshje, që njihet edhe si propozimi evropian, synon t'i çojë palët drejt një marrëveshjeje përfundimtare për normalizimin e raporteve.

I pyetur për kërkesën e Shteteve të Bashkuara që marrëveshja e arritur në Ohër të Maqedonisë së Veriut të zbatohet menjëherë, Kurti u pajtua duke thënë se "zbatimi i kësaj marrëveshjeje duhet të fillojë qysh dje".

Kryeministri ka theksuar se "topi" tashmë është në anën e Serbisë, duke argumentuar se theksi duhet të vendoset te refuzimi i Serbisë që ta nënshkruajë



marrëveshjen e jo te pyetja për të se kur do ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Për këtë të fundit, ai tha se është në kontakt të vazhdueshëm me ndërmjetësuesit e BE-së dhe të ShBA-së. "Do të duhej që atë formulimin për vetëmenaxhimin e komunitetit serb ta adresojmë. Çështjet që na paskan ngelur pa u përbushur dhe për ne bëhet fjalë një formulim që i përket në mënyrë shumë besnike dhe të saktë Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare sipas Këshillit të Evropës", ka thënë ai.

Propozimi evropian për normalizim, që përbëhet nga 11 nene, nuk përmend në mënyrë

specifike njohjen e ndërsjellë. Megjithatë, dokumenti kërkon nga të dyja vendet t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë pasaportat, diplomatat dhe targat. Propozimi evropian kërkon nga palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tash në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilin Qeveria e Kosovës e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund ta rrezikojë funksionalitetin e shtetit.

Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe 2015. Marrëveshja e

2015-s, sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nuk është në përputhje me aktin më të lartë juridik të shtetit. Megjithatë, pikat mund të harmonizohen me ligjin. BE-ja së fundmi i ka dorëzuar Qeverisë së Kosovës disa modele evropiane për të drejtat e komuniteteve joshumicë nga të cilat mund të merren shembuj për themelimin e Asociacionit. Qeveria e Kosovës ka konfirmuar se është duke i shqyrtuar ato. Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog me ndërmjetësimin e BE-së dhe me mbështetjen e ShBA-së që nga 2011. Kosova kërkon që në fund marrëveshja ta përfshijë njohjen reciproke, e Serbia dëshiron një zgjidhje kompromisi.

Refuzimi i Serbisë për të nënshkruar nuk dëshmon përkushtim

Ditmir BUSHATI,
ish-ministër i Jashtëm
i Shqipërisë

Takimi i Ohrit mes Kosovës e Serbisë i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian përfundoi me miratimin e planit të zbatimit të marrëveshjes të rënë dakord më 27 shkurt. E përbashkëta e të dy dokumenteve është mungesa e nënshkrimit të tyre. Refuzimi i Serbisë për të nënshkruar nuk dëshmon përkushtim të njëmendtë në këtë proces. Krejt ndryshe u soll Kosova duke dëshmuar vullnetin e saj për të nënshkruar të dy dokumentet. Në këtë mënyrë, Kosova ndihmoi edhe partnerët ndërkombëtarë që gabimisht mendojnë se përkëdheljet ndaj Serbisë dhe jo rrethimi i saj nga histori suksesi, është rruga e shkëputjes së saj nga Rusia.

Përkundër pritshmërive, plani i zbatimit është edhe më i shkurtër se vetë marrëveshja dhe pa shumë detaje, siç ndodh zakonisht në të tillë dokumente. Mirëpo, në Ohër u ra dakord që



angazhimet e palëve në këtë proces të trupëzohen në rrugën e tyre drejt BE-së, çka pritet të

krijojë një sinergji më të mirë mes procesit të dialogut dhe procesit të anëtarësimit në BE të Kosovës

dhe Serbisë. Pas mbështetjes unanime të shteteve anëtare të Marrëveshjes së 27 shkurtit, plani

franko-gjerman zyrtarisht u transformua në një plan evropian, me mbështetjen edhe të ShBA-së. Kësisoj, BE-ja nuk është më vetëm në pozicionin e ndërmjetësuesit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, por edhe e përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e angazhimeve. Proces ky i ndërlidhur me anëtarësimin e Kosovës dhe Serbisë në BE. Nëse në të shkuarën BE-ja ka treguar në jo pak raste mungesë besueshmërie, duke mos iu përbajtur zotimeve të saj përkundrejt shteteve të rajonit, me këtë pozicionim të ri BE-ja ka mundësinë e artë për të përfunduar procesin e shtetësisë së Kosovës, evropianizimin e Serbisë dhe anëtarësimin e të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE, sa më shpejt që të jetë e mundur. Mënyra më e mirë për t'iu përgjigjur agresionit rus në lindje të kontinentit është përmbyllja e pasojave të luftërave në ish-Jugosllavi dhe konsolidimi i projektit evropian në një hapësirë gjeografike, që rrethohet nga shtete anëtare të BE-së, siç është Ballkani Perëndimor.

Bombarduesit rusë fluturojnë afër Japonisë

MOSKË, 21 MARS - Dy bombardues strategjikë rusë kanë fluturuar mbi Detin e Japonisë për më shumë se shtatë orë, ka njoftuar Ministria ruse e Mbrojtjes më 21 mars, në ditën kur kryeministri japonez zhvillon vizitë në Ukrainë. Avionët e llojit Tupolev Tu-95MS janë të aftë të bartin armë bërthamore dhe Moska vazhdimisht i përdor ata për të kryer fluturime në ujërat ndërkombëtare në Arktik, në Atlantikun e Veriut dhe në Paqësor për ta treguar forcën e saj. Megjithatë, koha kur

bombarduesit fluturuan mbi Detin e Japonisë është pikërisht kur kryeministri i Japonisë, Fumio Kishida, nis vizitën në Ukrainë, për t'i ofruar mbështetje dhe për të shprehur solidaritet me presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, shteti i të cilit po përballet me pushtimin rus. Rusia tha se bombarduesit kryen "fluturime të planifikuara". Ato, sipas Moskës, shoqëruan disa avionë luftarakë. Bombarduesit nuk shkelën ligjet ndërkombëtare dhe

fluturuan mbi ujërat neutrale, tha Ministria e Mbrojtjes së Rusisë. Në shkurt, forcat e mbrojtjes ajrore të Amerikës së Veriut u dërguan për të penguar disa bombardues strategjikë rusë dhe avionët luftarakë, të cilët po fluturonin mbi hapësirën ajrore afër Alaskës. Japonia, që ka mosmarrëveshje territoriale me Moskën lidhur me disa ishuj në veri të Paqësorit, është aleate kyçe në Azi e Shteteve të Bashkuara dhe është anëtare e Grupit të Shtatë demokracive të pasura.



Tokio u është bashkuar ajo nisi pushtimin e sanksioneve perëndimore të paprovokuar të Ukrainës më vendosura ndaj Rusisë, pasi 24 shkurt 2022.

Një ministre gjermane viziton Tajvanin pas 26 vjetësh

BERLIN, 21 MARS - Ministria e Arsimit e Gjermanisë nënshkroi një marrëveshje për bashkëpunim në fushën e teknologjisë me Tajvanin, teksa realizoi vizitën e parë të një anëtari të kabinetit të Gjermanisë në 26 vjet. Ministria Bettina Stark-Watzinger nënshkroi marrëveshjen për shkencë dhe teknologji me Këshillin Kombëtar të Shkencës dhe Teknologjisë së Tajvanit në ditën e parë të vizitës së saj në Tajvan teksa Kina e ka dënuar këtë vizitë. Pekini e cilëson këtë ishull vetëqeverisës si pjesë të territorit të tij dhe thotë se do ta marrë një ditë kontrollin e



Tajvanit, edhe me forcë nëse vazhdimisht kundërshton është e nevojshme. Kina vizitat dhe angazhimin e

Tajvanit me zyrtarët ndërkombëtarë. Sa herë ka pasur vizita në Tajvan të zyrtarëve të huaj, Kina ka shfaqur forcën e saj ushtarake dhe ka rritur presionin diplomatik dhe ekonomik, veçmas kur ka pasur vizita të politikanëve nga Shtetet e Bashkuara dhe Evropa. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes në Taipei, Stark-Watzinger tha se "është kënaqësi dhe nder i madh" për të që të jetë ministria e parë e Qeverisë gjermane që viziton këtë ishull në më shumë se dy dekada. "Kjo marrëveshje është për përforcimin e bashkëpunimit

në bazë të vlerave demokratike, transparencës, reciprocitetit dhe lirisë shkencore", tha ajo. Vizita e saj vjen pasi dy muaj më parë një delegacion i lartë i Parlamentit gjerman udhëtoi për në Tajvan, një lëvizje që u kritikua ashpër nga Pekini. Stark-Watzinger, kur u pyet për kundërshtimet e Kinës për vizitën e saj, nuk pranoi të komentonte. Ministria e Jashtme gjermane javën e kaluar riafrmoi përkushtimin e saj për politikën "Një Kinë", pasi me Pekinin ka raporte dypalëshe, por po ashtu mban "raporte të ngushta dhe të mira me Tajvanin".

Amazoni do të shkurtojë edhe 9 000 vende të tjera të punës

WASHINGTON, 21 MARS - Gjiganti i shitjeve online Amazon planifikon të shkurtojë 9 000 vende të punës në tentim e sipër për t'i zvogëluar shpenzimet. Kompania, e cila punëson 1.5 milion njerëz në gjithë botën, ka thënë se ky shkurtrim do të prekë më shumë sektorin e ruajtjes së të dhënave dhe atë të reklamimit. Në njoftim nuk janë përmendur shtetet që do të preken, mirëpo është thënë se pozitat do të mbyllën në javët në vazhdim.

Shefi i Amazonit, Andy Jassy, e ka konsideruar vendimin si "të vështirë", mirëpo më të mirin për kompaninë, në periudhë afatgjatë. Në janar të këtij viti kjo kompani ka mbyllur 18 000 vende të punës. Jassy ka thënë se në vitet e fundit biznesi i Amazonit ka shtuar vazhdimisht vende të punës. "Megjithatë, duke marrë parasysh situatën e paqëndrueshme ekonomike në të cilën jemi, dhe paqartësitë që ekzistojnë për të ardhmen, ne kemi vendosur të jemi më të

kujdesshëm në shpenzimet tona", ka thënë ai. Sikurse shumë gjigantë të tjerë teknologjikë, Amazoni ka përjetuar rritje të jashtëzakonshme në periudhën e pandemisë së koronavirusit, kur njerëzit janë bllokuar nëpër shtëpitë e tyre. Mirëpo së fundi shkalla e shitjeve ka rënë, pasi konsumatorët kanë shpenzuar më pak për shkak të rritjes së çmimeve. Përveç pandemisë, në këtë rritje ka ndikuar edhe lufta e Rusisë në Ukrainë.



Luftime të ashpra në Ukrainë teksa kryeministri japonez viziton Kievin



KIEV, 21 MARS - Rusia ka shtuar ofensivën në rajonin lindor ukrainas të Donjeckut në 24 orët e fundit, ka njoftuar ushtria ukrainase më 21 mars. Këto njoftime vijnë teksa kryeministri i Japonisë ishte nisur drejt Kievit për ta treguar mbështetjen e tij për

Ukrainën që po përballet me pushtimin e paprovokuar rus. Mbrojtësit ukrainas kanë zbrapsur 120 sulme, të përqendruara kryesisht në Bahmut. "Ky qytet është pika qendrore e luftimeve për muaj të tërë dhe luftimet kanë shkaktuar humbje të

mëdha në të dyja palët", ka njoftuar Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase në raportimin ditor, duke shtuar se rusët, po ashtu, kanë tentuar të përparojnë në drejtim të Avdijivkës, Limanit, Marijnikës dhe Shahtarskut.



DASH: Korrupsioni qeveritar dhe dhuna me bazë gjinore, ndër problemet kyçe në Kosovë

Departamenti Amerikan i Shtetit thotë se çështjet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë vitit të kaluar ishin korrupsioni serioz i qeverisjes dhe mosndëshkimi i tij, mungesa e hetimit dhe përgjegjësisë për dhunën me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje ose nga partnerët, dhunën seksuale dhe forma të tjera të kësaj dhune, dhe krime që përfshijnë dhunë ose kërcënime për dhunë ndaj pakicave etnike ose komuniteteve të tjera të marginalizuara

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 MARS - Korrupsioni serioz qeveritar dhe mungesa e hetimeve dhe përgjegjësisë për dhunën me bazë gjinore janë përmendur si disa prej problemeve më serioze në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në pjesën për Kosovën.

Probleme të tjera në raportin për vitin 2022 përfshijnë edhe format e tjera të dhunës, si dhe krime apo kërcënime ndaj minoriteve etnike e grupeve të tjera të marginalizuara. Teksa e ka publikuar raportin, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se raportet e publikuara për një pjesë të mirë të vendeve të botës demonstronjë përkushtimin e Shteteve të Bashkuara për t'i avancuar të drejtat e njeriut në botë.

Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri

Në raportin për vitin 2022 përmendet që ligji parashih

ndëshkime penale për zyrtarët e përfshirë në korrupsion, por që qeveria nuk e ka zbatuar ligjin në tërësi. "Kanë qenë disa raste të raportimit të korrupsionit në nivel qeveritar. Zyrtarët ndonjëherë janë përfshirë në praktika korruptive, pa u ndëshkuar. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe brishtësia për zbatim të ligjit kanë rezultuar me këtë problem", është thënë në raport.

Aty është përmendur se disa raste të korrupsionit janë apeluar vazhdimisht dhe se sistemi gjyqësor, me raste, e ka lejuar skadimin e afatit të parashkrimit të rasteve. "Në dhjetor të vitit 2021 Instituti i Kosovës për Drejtësi i ka identifikuar 11 raste të korrupsionit që kanë rrezikuar parashkrim; në janar shtatë nga këto raste kanë skaduar për shkak të parashkrimit". Në raport janë përmendur edhe Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit si përgjegjëse për luftim të korrupsionit qeveritar. "Deri në shtator Agjencia Kundër Korrupsionit ka publikuar 29 opinione për raste specifike që potencialisht kanë qenë konflikte

interesi dhe aktivitetet që në të ardhmen mund të përbëjnë konflikte interesi. Prokurorët kanë ngritur 150 aktakuza lidhur me korrupsionin dhe për 34 raste janë shqiptuar dënimet deri në tetor". Në raportin për vitin 2022 është përmendur, po ashtu, që

organizatat joqeveritare në Kosovë, por edhe organizatat ndërkombëtare, kanë vënë në pah disa herë dështimet e sistemit gjyqësor për t'i ndëshkuar rastet e korrupsionit, prandaj shumë pak raste të zyrtarëve të lartë, të përfshirë në këto shkelje, kanë përfunduar me dënime.

Për më shumë, në pjesën për korrupsion, janë përmendur edhe dy hetime të mëdha korrupsioni në kufi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. "Hetimet kanë rezultuar me arrestimin e 74 zyrtarëve të Policisë së Kosovës, dy zyrtarë të Doganave të Kosovës

dhe 34 zyrtarëve të Policisë së Shqipërisë. Më pas, në shtator, tre zyrtarë policorë janë dënuar me 15 deri në 30 muaj burgim për abuzim të pozitave të tyre, për pranim të rryshfetit dhe për ofrimin e ndihmës për kontrabandim mallrash në pikat kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë".

Në një pjesë të raportit përmendet që gjyqi i nisur më 2019 ndaj ish-ministrit të Bujqësisë, Nenad Rikallo, ende nuk ka epilog. Ai dhe tetë zyrtarë të tjerë të ministrisë janë akuzuar për abuzim të pushtetit, pasi dyshohet se kanë manipuluar me grante.

Krasniqi: Raporti i DASH-it shpërfaq dështimin e qeverisë Kurti për të ndërtuar institucione kredibile

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën shpërfaq dështimin e qeverisë Kurti për të ndërtuar institucione kredibile, të përgjegjshme dhe të pakorruptuara, në njërën anë dhe, në anën tjetër, dështimin për të krijuar një ambient ku vajzat dhe gratë janë të sigurta. "Raporti fakton korrupsionin serioz qeveritar dhe mosndëshkimin e rasteve të tilla, mungesën e hetimit dhe

përgjegjësisë për dhunën me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje apo dhunën seksuale, dhe ngrë shqetësimin se si zyrtarë të korruptuar vazhdojnë të mbajnë pozicione të larta në sektorin publik. Kjo është historia e vërtetë e kësaj qeverie, e cila, në dy vitet e fundit ka prodhuar vetëm skandale që kanë prekur të gjithë sektorët: qeverisjen, ekonominë, shëndetësinë, arsimin, diplomacinë e sigurinë. Padyshim, si emërues i përbashkët i cili vulosë të

gjitha këto gjetje që karakterizojnë Qeverinë Kurti, mbetet ambasadori Martin Berishaj, i cili, përkundër raportimeve, fakteve dhe akuzave, vazhdon të mbetet në detyrë pa dhënë asnjëherë llogari për miliona euro të shpërdoruara e të dyshimta", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka thënë se me Kurtin në qeverisje dhe Martinin si simbol të saj, raportet për Kosovën do të vazhdojnë të përkeqësohen vazhdimisht.

Kurti thotë se po bëhet një analizë për gjendjen e qendrave për punë sociale

PRISHTINË, 21 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë të martën në konferencën e Dytë Nacionale për Shënimin e Ditës Botërore të Punës Sociale në Kosovë, me temën "Profesionistët e punës sociale në sistemin e mbrojtjes sociale". Në fjalën e tij, kryeministri Kurti shprehu falënderim e mirënjohje për kontributin e pamohueshëm të punonjësve socialë duke thënë se realizimi i të drejtave sociale të qytetarëve, ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të mbrojtjes sociale, kërkon angazhim aktiv të punonjësve socialë. "Punonjësit socialë, me angazhimin e tyre të

përditshëm, mbështetnin qytetarët në ballafaqimin me problemet sociale dhe tejkalinin e tyre. Njëkohësisht i shërbejnë edhe vendit për të përparuar në aspektin social", u shpreh ai.

Teksa përmendi vëmendjen jo të duhur ndaj qendrave për punë sociale në të kaluarën, kryeministri tha se janë 38 qendra për punë sociale anembanë Kosovës në të gjitha komunat e saj dhe ato ofrojnë më shumë se 70 shërbime për qytetarët.

Në kuadër të agjendës legjislativë kryeministri veçoi projektligjin për shërbimet

sociale, që parasheh reformë të thellë të qendrave për punë sociale. Për këtë, shtoi ai, është bashkëbiseduar me shumë nga të pranishmit e sotëm në takimim e muajit të kaluar në kryeministri. "E grupi punues tashmë po bën një analizë të detajuar të gjendjes në këto qendra në raport me përgjegjësitë, sfidat dhe kapacitetet njerëzore dhe profesionale", ka deklaruar kryeministri.

Njëkohësisht, kryeministri Kurti ka thënë se bashkë po synojmë fuqizimin e qendrave përmes shtimit të kapaciteteve, obligimin për profilizimin e

stafit në përputhje me nevojat e qytetarëve. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës krahas politikave zhvillimore, e ka prioritet mbrojtjen sociale për qytetarët tanë, me programe adekuate dhe sidomos të qëndrueshme e afatgjatë. "Programi qeveritar përqendrohet në drejtësi sociale, në ndryshimin e parakushteve për transformimin e shoqërisë", është shprehur ai, duke theksuar se këtë qëllim do ta arrijnë vetëm nëse e arrijnë për të gjithë, pa privilegjuar ndokënd që bëhet diskriminim për të tjerët.

Ai rikujtoi që para katër ditëve është ekzekutuar mbështetja për punëdhënësit të cilët i kanë rritur pagat e 16 996 punëtorëve në sektorin privat, masë të cilën qeveria ka subvencionuar 50 për qind të rritjes së pagës për tre muajt e parë. Sipas Kurtit, kjo shënon kompletimin e të gjitha masave të Pakos për Përballje me Inflacionin. "Pakoja për Ringjallje Ekonomike dhe ajo për Përballje me Inflacionin që ka zbatuar qeveria jonë, kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe kanë ndihmuar familjet me buxhet të rënduar. Mbi 688 mijë qytetarë janë mbështetur nga shteti", ka deklaruar kryeministri Kurti.



Diskriminimi dhe abuzimet shoqërore

Në pjesën për mungesën e hetimeve për dhunën me bazë gjinore, raporti përmend se rastet e tilla, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunime të tjera, nuk raportohen shpesh nga viktimat për shkak të stigmës shoqërore dhe mungesës së besimit në autoritete. "Deri në shtator [të vitit 2022] prokurorët kanë hetuar 160 raste të dhunimeve dhe kanë ngritur 30 padi".

Në raport përmendet rasti i dhunimit të një 11-vjeçeje në Prishtinë nga pesë të dyshuar - një i rritur dhe katër të mitur. "Në dhjetor prokurorët kanë ngritur padi kundër të dyshuarve, duke i akuzuar për trafikim të personave, përdorim të shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit dhe pornografi

fëmijësh".

Më pas është përmendur edhe vrasja e shtatzënës 35-vjeçare në oborrin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në muajin nëntor. I dyshuari, burri i saj, i ka ikur arrestimit dhe ka kryer vetëvrasje dy ditë më vonë. "Policia e ka konfirmuar se viktima më parë ka raportuar për dhunë në familje dhe ka qenë në mbrojtje policore". Në raport konkludohet, po ashtu, se më pak gra mbajnë pozita udhëheqëse në biznese, polici apo qeveri. "Institucioni i Avokatit të Popullit ka raportuar se gratë janë shpesh subjekte të praktikave diskriminuuese të punësimit si dhe të formave të diskriminimit, përfshirë ngacmimet seksuale në vendin e punës si në sektorin publik, ashtu edhe atë privat".

Sipas gjetjeve të raportit, gratë në Kosovë "janë të nënpërfaqësuar në tregun e punës, pasi vetëm një në pesë gra është pjesë aktive e

tregut formal të punës".

Në raport përmendet edhe aktiviteti i Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës gjatë vitit të kaluar.

Sa i takon lirisë së shprehjes, raporti vë në dukje se pati raporte të besueshme se disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe fetare u përpoqën t'i frikësonin përfaqësuesit e medias. "Problemet me fondet, po ashtu, minuan pavarësinë e medias. Gazetarët hasën vështirësi në marrjen e informacionit nga qeveria dhe institucionet publike pavarësisht nga ligjet që ofrojnë qasje në dokumente publike", thuhet në raport.

Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës njoftoi se ishte vënë në shënjestër disa herë nga fushatat e shpifjeve në botën digjitale kur kishte mbrojtur gazetarët dhe mediet.

Kurti për raportin e DASH-it: Kritikkat do t'i marrim me shumë seriozitet

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka thënë se gjetjet e raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) do t'i adresojnë me shumë seriozitet. Kreu i qeverisë ka thënë se Kosova ka shënuar përparim në luftën kundër korrupsionit. Ai ka shtuar se kritikrat do të merren me shumë seriozitet dhe do të trajtohen me përpikëri. "Ne bëjmë maksimumin e mundshëm, nuk e kursejmë as vullnetin, as përpjekjen e as dijen që e kemi. Gjatë këtyre dy vjetëve Kosova ka shënuar përparime të mëdha. A jemi aty ku duam? Ende jo. Mirëpo të gjitha ministratë, teksa shënojmë këtë javë dyvjetorin në qeverisje, e bëjnë më të mirën e mundshme. Edhe vërejtjet, kritikrat të cilat na jepen, do t'i marrim me shumë seriozitet e do t'i trajtojmë me përpikëri", ka thënë Kurti.

Hagë, heshtja e frikshme përballë Speciales

Shkruan: Arben AHMETI

Hashim Thaçi mund ta ketë pasur mbiemrin Veseli. Kësisoj ne do ta njihnim Hashim Veselin dhe Kadri Thaçin, ose Rexhep Krasniqin me Jakup Selimin. Nuk është larg mendsh që ndonjëri prej tyre mund ta ketë pasur emrin Albin, ose mbiemrin Konjufca.

Emrat dhe mbiemrat nuk janë fare të rëndësishëm. E rëndësishme është qenia e një procesi. Proces ku disa njerëz mbahen në një paraburgim që nuk është as burg e as qendër klasike e mbajtjes, dhe nuk e kanë të qartë se kush po i akuzon, për çka po i akuzon, dhe cila është logjika prapa këtij procesi. Nuk dihet se kush i akuzon, sepse gjykata as nuk është e Kosovës dhe as nuk është ndërkombëtare. Nuk dihet për çka akuzohen sepse u thuhet që keni përgjegjësi për disa veprime të njerëzve që vështirë të kuptohet nëse këta i kanë njohur e lëre më takuar ndonjëherë.

Nuk ka logjikë sepse kur identiteti i gjykatës që është pika A, dhe përmbajtja e akuzës që është pika B, nuk kanë lidhje logjike, nuk ka se si të jetë e logjishme pika C, e që është rezultati i procesit.

Andaj emrat nuk janë të rëndësishëm. Ata mund të jenë secili qytetar i botës. Sikur që ishte Jozef K tek Procesi i Kafkës.

Seanca parapërgatitore

Shiu dhe mungesa e diellit janë normale në qytetin e Hagës. Edhe qetësia e njerëzve që ecin në rutinën e përditshme të tyre. Gjithçka e qetë, e ngadalshme, besa edhe e mërzitshme.

Ngadalë nisë edhe seanca e fundit parapërgatitore.

Secili prej pjesëmarrësve në proces është më i pispillosur se tjetri. Më i qetë se tjetri. Askujt nuk i ngutet.

Askush nuk ndjen kurrfarë presioni.

Të vetmit në presion janë katër të akuzuarit. Burrat që nuk e ruajtën qetësinë nën regjimin e Millosheviqit dhe e luftuan atë në një përballje skajshmërisht të pabarabartë, por me vull e me shumë energji, duhet tani ta



ruajnë qetësinë para një gjykatores që u thotë se do të jenë të barabartë në këtë betejë. "Barazia e armëve" siç njihet në gjuhën juridike i një procesi që në pamjen e parë shfaqet qetë, ngadalshëm dhe mërzitshëm. Për të akuzuarit sidomos.

Duket se Thaçi, Veseli, Selimi e Krasniqi e kanë kuptuar, andaj edhe ata shfaqen të qetë. Aq komod sa nuk vijnë fare në gjykatores. E përcjellin online nga qendra e mbajtjes. As unë dhe Fidani nuk hyjmë në gjykatores. Të ngadalshëm, të vonshëm e të qetë ishim edhe ne.

A është e Kosovës?!

Më 3 mars bëmë kërkesën që t'i takojmë edhe të paraburgosurit. Qëllimi i vizitës sonë mbetej seanca parapërgatitore. Kishim synim të merrnim pjesë në një seancë për të kuptuar ndjenjën se çfarë na pret nga 3 prilli kur të nisnin seancat e rregullta.

Andaj takimi me të akuzuarit

duhet të ishte në datat para ose pas seancës.

Gjykata që është e Kosovës, dhe që gjuhën shqipe pre supozohet ta ketë zyrtare, na kërkon pas disa ditësh që formularin e kërkesës për takim ta plotësojmë edhe në gjuhën angleze. Hera e parë që një vizitori i kërkohej diçka e tillë. Kërkesë simpatike por që doli pastaj absurde dhe pengesë për t'i takuar të paraburgosurit. Kur ua përcollëm kërkesën në gjuhën angleze, ofruam të njëjtat arsye për vizitën dhe të njëjtat data. Përgjigja na u kthye se duhet ndryshuar data sepse nuk ishte respektuar afati që kërkesa të bëhej 15 ditë para vizitës.

Pra gjykata që është e Kosovës, e kishte shpallur të pavlefshme një kërkesë në gjuhën shqipe, vetëm sepse ishte e shkruar shqip. Nuk e besoj që gjykata e ka pasur problem gjuhën shqipe. Sidoqoftë, besoj që qëllimi ishte të pamundësohet vizita. Nuk i

duan gazetaret afër gjykatës dhe brenda saj kur ka seanca. E prishin qetësinë, ngadalësinë e atij sistemi që frymon në kurriz të Kosovës. Edhe krijojmë presion. Ia humbim kuptimin procesit. Ia humbim hijeshinë kafkiane. Besoj se do të duhej të jetë kështu.

Qetësia që nuk i duhet procesit

Nuk ka diplomatë që nuk vlerëson se ajo që ka ndodhur me aktakuzën është e çuditshme dhe gabim. Dy fytyrat kryesore të shpalljes së pavarësisë, dhe njerëzit më reprezentativë të rezistencës që solli lirinë, po mbahen në një proces ku nuk u garantohet as e drejta minimale e efikasitetit të procesit.

Heshtja e deritanishme ndaj kësaj padrejtësie është absurde. Hesht qeveria, hesht presidenca,

hesht parlamenti dhe shoqëria civile. Kjo gjendje nuk i ndihmon askujt. As gjykatës. As vetë prokurorit të specializuar. Andaj secili duhet të marrë pjesë në marshet e paralajmëruara. Qoftë në atë në Prishtinë me 2 Prill, apo në tjetrin në Hagë me datën 3. Marshe do të duhej të kishte gjithandej.

Sepse marshimi në mbështetje të tyre nuk nënkupton që nesër do ta votosh Hashim Thaçin e Kadri Veselin në PDK, Rexhep Selimin në VV apo Jakup Krasniqin në Nisma. Sepse emrat janë të rastësishëm. Ata mund të jenë secili qytetar i botës së lirë. Sikur tek një prej veprave më të njohura të letërsisë gjermane të absurdit tek Procesi i Kafkës.

Edhe Gjykata Speciale një ditë do të dalë vepër e absurdit. Nuk e di nëse do të vlerësohet si vepër gjermane, amerikane, evropiane apo ruse. Do të jetë fare pak e rëndësishme.



Bosch: Gjyqtarët e Speciales po marrin paga të majme në kurriz të të pandehurve, pse nuk i lejoni të shkojnë në shtëpi?

PRISHTINË, 21 MARS - Ish-ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch, i ka kritikuar Gjykatën Speciale dhe Prokurorinë Speciale lidhur me kohëzgjatjen e parashtrimit të lëndës për ish-kryerët e UÇK-së.

Bosch, me anë të një postimi në "Facebook", ka

thënë se gjyqtarët në Speciale po marrin paga të majme në kurriz të ish-kryerëve të UÇK-së. Ai ka pyetur se pse nuk po lihen ish-kryerët e UÇK-së të rikthehen në shtëpitë e tyre e ta presin gjyqin. "Duket se gjyqtarët duan të mbajnë sa më gjatë punët e tyre të

paguara mirë në dëm të të pandehurve. Pse nuk mund të shkojnë në shtëpi e të presin gjyqin?", ka pyetur Bosch.

Reagimi i ish-diplomatit holandez vjen pas kërkesës së Prokurorisë Speciale që parashtrimi i lëndëve të tyre të zgjasë gjashtë vjet.

Policia e Kosovës tani ka zyrtarin e saj ndërlidhës në EUROPOL

PRISHTINË, 21 MARS - Policia e Kosovës (PK), në vazhden e avancimit dhe rritjes së mëtejme të kapaciteteve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, konkretisht të bashkëpunimit me EUROPOL-in, tani ka dërguar zyrtarin e parë ndërlidhës në EUROPOL, major

Besnik Sallahu, i cili ditë më parë ka filluar zyrtarisht detyrën. Qëllimi primar i PK-së vazhdon të mbetet avancimi i mëtejme i bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me EUROPOL-in, bashkëpunim ky i cili ndihmon dhe ndikon në lehtësimin e komunikimit dhe krijimit të një partneriteti të drejtpërdrejtë,

duke përfshirë edhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet EUROPOL-it dhe institucioneve të zbatimit të ligjit, në angazhimin e vazhdueshëm të luftës së përbashkët kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe të gjitha formave të tjera të krimit.



Shoqata e të Burgosurve Politikë mbështet marshin për drejtësi në solidarizim me krerët e UÇK-së në Hagë



Prishtinë, 21 mars - Pak ditë para mbajtjes së marshit për drejtësi të ftuar nga platforma "Liria ka emër", e thirrur më 2 prill, nga ora 14:00 në Prishtinë, ideatori i platformës, Ismail Tasholli, ka

takuar Shoqatën e të Burgosurve Politikë. Kryetarin Shefik Sadiku dhe anëtarë të tjerë të kësaj shoqate, Tasholli i ka informuar për idenë e marshit solidarizues dhe organizimin e tij që

do të mbahet një ditë para nisjes së procesit gjyqësor ndaj krerëve të UÇK-së në Hagë. Kryetari i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës, Shefik Sadiku dhe anëtarët e pranishëm në këtë


takim, deputeti Hydajet Hyseni dhe Berat Luzha, pasi u informuan për qëllimin e marshit konfirmuan mbështetjen për të, ndërsa theksuan se krerët e UÇK-së në Hagë, tash e dy vjet po mbahen si

të burgosur politikë. Marshi për drejtësi në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së do të nisë nga sheshi "Zahir Pajaziti" dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit "Skënderbeu".

Osmani i kërkon presidentit të Izraelit mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare

PRISHTINË, 21 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar të martën një bisedë telefonike me presidentin e Izraelit, Isaac Herzog, si pjesë të komunikimit të vazhdueshëm me homologë të shteteve mike. Presidenca ka njoftuar se në këtë bisedë telefonike në mes të krerëve të shtetit të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Izraelit, të dy liderët kanë biseduar për raportet bilaterale në mes të dy shteteve dhe për mundësinë e thellimit të tyre. "Presidentja Osmani dhe

presidenti Herzog diskutuan për potencialin e rritjes së bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, trashëgimisë kulturore dhe inovacionit, ndërsa vlerësuan lart partneritetin në rritje në mes të dy vendeve. Në këtë drejtim presidentja Osmani potencoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit diplomatik për ta mbështetur anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare", ka njoftuar Presidenca. Më tutje, në njoftim theksohet



se presidenti Herzog e falënderoi për zëmërisht presidenten Osmani për mbështetjen e Kosovës ndaj Izraelit dhe e ftoi Osmanin për vizitë zyrtare në Izrael. "Ai, po ashtu, shfrytëzoi rastin që t'ua urojë muajin e Ramazanit besimtarëve myslimanë, festën e Pashkëve besimtarëve të krishterë, si dhe festën e 'Passover' besimtarëve hebre. Në fund, presidentja Osmani ka dërguar urimet më të mira për gjithë popullin e shtetit të Izraelit", ka njoftuar Presidenca.

149 gjoba për shkelësit e Ligjit të Duhanit

PRISHTINË, 21 MARS - Për më pak se një javë janë shqiptuar gjoba për 149 raste të shkeljes së Ligjit për Kontrollin e Duhanit ka bërë me dije ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci. Ai ka theksuar se nga 16 marsi e deri më sot kanë bërë 683

inspektime në terren. "Ne vetëm po bëjmë detyrën tonë për të cilën kemi mandatuar. Ajo që po me bën të ndihem krenar është kultura e masave qytetare të cilët po e shprehin në respektim të vullnetshëm të ligjit. Ata të cilët në çfarëdo forme tentojnë t'i shkelin

rregullat, sigurisht se do të përballen me masën ndëshkimore që e ka përcaktuar ligji. Nga data 16 deri më sot kemi realizuar 683 inspektime nga të cilat kemi hasur në 149 raste të shkeljes së ligjit për të cilat raste kanë pasuar gjobat", ka thënë Peci.



ATK-ja dhe Inspektorati i Punës arrijnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 21 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Inspektorati i Punës (IP) kanë arritur memorandum bashkëpunimi i cili ka për qëllim të mundësojë që ATK-ja dhe IP-ja të punojnë ngushtë së bashku për t'i përmirësuar përpjekjet institucionale për ta trajtuar punën e padeklaruar përmes shkëmbimit më të mirë të të dhënave, informacionit, përvojave si dhe organizimit të aktiviteteve të përbashkëta. Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se ky memorandum bashkëpunimi është përpiluar

mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe angazhimeve konkrete të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Inspektorati i Punës, në njohje të mundësive potenciale për përmirësimin e përpjekjeve institucionale për trajtimin e punës së padeklaruar në Kosovë nëpërmjet bashkëpunimit më të ngushtë, shkëmbimit të të dhënave në kohë reale ndërmjet dy institucioneve. Ndërsa kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi, ka theksuar se

memorandumi në fjalë është në funksion të ngritjes dhe lehtësimit të mëturjes së bashkëpunimit ndërinstitucional duke marrë për bazë faktin se puna e padeklaruar është një fenomen kompleks, që ndikohet nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm ekonomikë, socialë, institucionalë dhe kulturorë dhe që trajtimi i shkaqeve dhe pasojave të punës së padeklaruar kërkon një qasje të balancuar, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse ndërmjet dy institucioneve.



BQK-ja shënon fillimin e aktiviteteve të Javës Ndërkombëtare të Parasë

PRISHTINË, 21 MARS - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka hapur Javën Ndërkombëtare të Parasë, aktivitet i cili tashmë tradicionalisht shënohet në Kosovë. Para nxënësve të Shkollës së Mesme "Sami Frashëri", guvernatori Fehmi Mehmeti ka folur rreth rolit të BQK-së në edukimin financiar, duke dhënë kontribut në informimin dhe ngritjen e njohurive të qytetarëve, me qëllim të përmirësimit të njohurive të tyre rreth koncepteve ekonomike dhe financiare, produkteve, shërbimeve që i ofron sektori financiar dhe krijimit të shprehive për të bërë zgjedhje të duhura dhe ndërmarrje veprime efektive për ta përmirësuar mirëqenien e tyre financiare. Sipas guvernatorit Mehmeti, kjo

ndihmon në zvogëlimin e rrezikut të krizave financiare dhe në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. Në diskutimin e mbajtur në BQK nxënësit kanë parashtruar pyetje të ndryshme rreth sektorit financiar dhe rolit të BQK-së në ekonominë e Kosovës. Në hapje të Javës Ndërkombëtare të Parasë, BQK-ja ka shpallur konkurs për ese me temën e motos së kësaj jave "Planifikoni paratë tuaja, mbillni të ardhmen tuaj", i cili do të qëndrojë i hapur deri më 30 prill 2023, ku shtatë esetë më të mira do t'i fitojnë shtatë çmime. BQK-ja nga viti 2013 është pjesë e këtij organizimi i cili udhëhiqet nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), në të cilin marrin pjesë 176 vende të



botës dhe planifikohet të marrin pjesë mbi 50 milionë nxënës e të rinj nga shtete të

ndryshme të botës. Gjatë kësaj jave BQK-ja do të organizojë ligjërata të

ndryshme me nxënës të disa komunave të vendit dhe të komuniteteve të ndryshme.

Sindikata e Gjykatës Themelore në Prishtinë kërkon korigjimin e koeficienteve për pagat



PRISHTINË, 21 MARS - Shoqata Sindikale e Administratës së Gjykatës Themelore në Prishtinë kërkon nga Ministria e Punëve të Brendshme t'i korigjojë listat e pagave të muajit shkurt dhe në pagat për muajin mars ta zbatojë vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18.01.2023. Në njoftimin e kësaj sindikate thuhet se me listat e pagave të muajit shkurt shumë pozita të stafit të administratës së gjykatave dhe prokurorive kanë pësuar degradim në pozita dhe ulje page. "Ministria e Punëve të

Brendshme, si hartuese e Ligjit për Paga në sektorin publik, t'i korigjojë listat e pagave të muajit shkurt pasi shumë pozita të stafit të administratës së gjykatave dhe prokurorive kanë pësuar degradim në pozita për koeficiente dhe ulje page. Po ashtu, për pagat për muajin mars ta zbatojë vendimin e KGJK-së dt. 18.01.2023 pasi është në diskrecion të KGJK-së që pozitat e të gjithë të punësuarve t'i klasifikojë sipas vendeve të punës duke mos dalë nga korniza e koeficienteve të përcaktuar nga ana Qeverisë

së Republikës, respektivisht Ministrisë së Punëve të Brendshme", ka njoftuar kjo sindikatë. Shoqata Sindikale e Administratës së Gjykatës Themelore në Prishtinë ka konstatuar se moszbatimi i vendimit të lartshënuar nga institucionet relevante dhe injorimi i kërkesave të stafit të administratave të gjykatave dhe prokurorive për një pagë të dinjitetshme dhe kushte më të mira të punës do ta detyrojë aktivizimin e grevës e pezulluar kohë më parë.

Ndahen edhe 7.2 milionë euro për subvencionimin e energjisë elektrike

PRISHTINË, 21 MARS - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar mbledhjen elektronike në të cilën ka ndarë 7,278,747.59 euro për zbatimin e masës 3.7 -

Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Mjetet e ndara do të përdoren për subvencionimin e energjisë

elektrike për konsumatorët fundorë, me qëllim të uljes së ndikimit të tarifave të energjisë, që reflektojnë në faturat e konsumatorëve. Kushtet dhe

kriteret e shfrytëzimit të këtyre mjeteve përcaktohen me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 21/94 të datës 24 gusht 2022.



Pse po pakësohet numri i vrasësve serialë?



Nga Emmanuel
PIETROBON

Vrasësit serialë kanë qenë për shumë kohë muza e frymëzimit për shkrimtarët dhe skenaristët. Ata kanë zhytur në zi familje të tëra. Dhe gjatë viteve 1990 ata i dhanë shumë sukses kinemasë së zhanreve horror dhe thriller, duke frymëzuar saga të frikshme por të suksesshme si “E premtja e datës 13”, “Halloween” dhe “Scream”.

Vrasësit serialë janë të paktë në numër. Por kanë vranë dhjetëra mijëra njerëz në mbarë botën. Kështu 10 vrasësit serialë kryesore në histori, vranë së bashku 898 njerëz. Shkenca e krimnologjia i ndan në të organizuar dhe të ç’organizuar, por edhe në “misionarë” dhe “vejusha të zeza”, në hedonistë dhe në njerëz me mendje të trazuar.

Disa nuk e arrijnë pragun minimal të pranueshëm të Koeficientit të Inteligjencës (IQ), të tjerë kanë një inteligjencë mbi mesataren. Vrasësit serialë, makth i njerëzve të zakonshëm,

obsesioni i profilitëve dhe kurioziteti i sociologëve. Qofshin metodikë apo të çrregullt, pre e halucinaçioneve apo tejet të kthjellët në veprime, është e sigurt që për fat të mirë kjo lloj specie është në prag të zhdukjes.

“Epoka e Artë” e vrasësve serialë zgjati rreth 40 vite, nga vitet 1950 deri në vitet 1990, dhe pati një ndikim të thellë në imagjinatën kolektive të perëndimorëve por edhe pjesës tjetër të botës. Edhe sot, dekada më vonë, filmat dhe serialet mbi protagonistët e mëdhenj të kësaj epoke janë në gjendje të tronditën publikun siç e tregon edhe seriali mbi vrasësin serial XhefriDahmer në Netflix.

Amerika Puritane e interpretoi fenomenin e vrasësve serialë në terma eskatologjikë, pra duke e lexuar atë si një sinjal të “fundit të afërt të botës”. Për Bashkimin Sovjetik, kjo dukuri ishte një nga shenjat e shumta të rënies së qytetërimit të degjeneruar perëndimor. Prandaj hezitoi që të lidhte zhdukjen e rreth 50 njerëzve me një njeri të vetëm: Andrej Çikatilo.

Për Japoninë, dukuria e vrasësit serialë, ishte një pasojë e paqëllimshme e perëndimorizimit shoqërisë japoneze. Gjithsesi u duk si një tendencë e destinuar të zgjaste shumë. Por nuk ndodhi kështu. Sipas vlerësimeve zyrtare, numri i vrasësve serialë aktivë në SHBA ka ardhur duke u zvogëluar në mënyrë drastike nga fundi i shekullit XX.

Ata ishin 770 në vitet 1980, 670 në vitet 1990, dhe më pas numri ra nga 400 në fund të shekullit XX, dhe ishte në pak më shumë se 100 në periudhën 2010-2020. 189 vrasje iu atribuuan vrasësve serialë vetëm në vitin 1987. Kjo shifër ishte vetëm 30 në vitin 2015.

Por cilat janë arsytet e mundshme të kësaj rënieje? Për krimnologët arsyeja kryesore është progresi teknologjik. Përparimet, zhvillimet dhe zbulimet e reja në fushën e mjekësisë ligjore, nga teknologjia e informacionit tek leximi i ADN-së, kanë e përmirësuar ndjeshëm efektivitetin e departamenteve hetimore, të cilat ndërmjet analizës së materialit biologjik dhe të dhënave të tjera, janë në gjendje të ngadalësojnë

vazhdimin e vrasjeve zinxhir dhe madje të zgjidhin krimet misterioze të së kaluarës së largët.

Nga ana tjetër videokamerizimi i hapësirave urbane dhe jo urbane, si rrugët dhe autostradat, ua ka vështirësuar aktivitetin kriminal këtyre njerëzve. Për shembull sot në në Shtetet e Bashkuara, ka 1 kamerë për çdo 4.6 persona. Po ashtu, në krahasim me të kaluarën, sot komisaritet dhe departamentet dialogojnë, shkëmbejnë të dhëna dhe tendenca drejt bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet forcave policore të vendeve të ndryshme.

Ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur edhe tek vetë shoqëria. Në vendet e zhvilluara është zhdukur fenomeni i “autostopit”, që historikisht ka qenë një burim i rëndësishëm viktimash për vrasësit serialë. Sot telefonat janë të pajisur me gjeolokacionin dhe alarmin e kërkimit të ndihmës.

Gjithsesi përparimi teknologjik dhe ndryshimet sociale mund të shpjegojnë vetëm pjesërisht pakësimin e madh të vrasësve serialë. Sepse nëse është e

vërtetë që vrasjet në seri janë bërë më të vështira, i tillë është edhe fakti që të paktën në kontekste të caktuara, duket se ka ndryshuar mënyra e “idealizimit” të vrasjes.

Dhuna duket se ka ndryshuar, ajo është më pak e përpunuar dhe më spektakolare. Disa sociologë dhe krimnologë, veçanërisht midis Shteteve të Bashkuara dhe Japoni, besojnë në ekzistencën e një lidhje midis uljes (të jashtëzakonshme) të vrasjeve serike dhe rritjes (të jashtëzakonshme) të dy dukurive të tjera kriminale: vrasjeve të dhunshme dhe masakrave.

Pra rrëmbimeve që përfundojnë me vrasje, tragjedi familjare dhe masakrat famëkeqe nëpër shkolla.

Nëse masakrat mizantropike, mini-vrasësit serialë dhe vrasësit e egër të viteve 2000 janë ekuivalenti bashkëkohor i vrasësve serialë të shekullit XXI, apo nëse këto janë fenomene krejtësisht të palidhura, e vetmja gjë e sigurt është një: po perëndon epoka e vrasësve serialëtradicionale, e nisur dikur nga Xhek Rrjepësi. / “Il Giornale” – Bota.al

Fan Noli, lëvrues i madh i fjalës shqipe



Nga: Qemal MURATI

“Shqipëruet gjenial, me mjeshtri e shije si pakkush, në një masë më të madhe se çdokush tjetër, ky lëvrues i madh i fjalës shqipe i çoi lart mundësitë shprehëse të gjuhës sonë duke kontribuar që të ngrihet kjo në rangun e gjuhëve më të zhvilluara, e aftë për të shprehur çdo mendim, sado të lartë, çdo ndjesi, sado të hollë”

Mahir Domi

“Fjalët turqishte që kanë hyrë në gjuhë e që i kupton populli anembanë Shqipërisë, janë shqipe më e mirë se neologjizmat e pakripura dhe të pakuptueshme”
Fan Noli

Fan Noli, si rrallëkush tjetër, është një institucion më vete, të cilit bota shqiptare i mbetet borxh për shumëçka. I mbetet borxh edhe gjuha shqipe, për fannolikatin e tij të papërsëritshme, po aq sa edhe ky i mbetet borxh gjuhës shqipe, që kjo gjuhë i dha atij forcën dhe krenarinë e të qenit shqiptar. Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë jo duke thënë fjalë të mëdha e të përzgjedhura për të në përvjetorë të rastit, por duke punuar për gjuhën shqipe e duke përdorur korrekt shqipën standarde. Për këtë gjuhë punoi

aq shumë edhe ky tribun, për të cilën ne punojmë aq shumë për ta degraduar e rrënuar pamëshirshëm e barbarisht.

Është vështirë të thuhet sot se cili ishte roli më i rëndësishëm i Nolit: si letrar, si publicist, si historian, si kishtar, si politikan, si përkthyes, si muzikolog, si poliglot etj. Por, një gjë nuk është vështirë të dihet, që Noli ishte me më shumë njohje gjuhe dhe përdori shqipën më të rrjedhshme që mund të kesh sot.

Fannolikati e papërsëritshme

Sa herë që e bie puna ta zëmë në gojë emrin e madh të Fan Nolit – kur lexojmë ndonjë vepër të tij apo kur citojmë ndonjë mendim a thënie me vlerë, nga ato fannolikati (që të kujtojnë filipikat e Demostenit, fjalimet e famshme politike të tij kundër mbretit Filipit II të Maqedonisë), na shkon mendja gjithnjë te figura shumëdimensionale e tij: e poetit, historianit, politikanit, shtetarit, muzikantit, klerikut, përkthyesit, poliglotit nga më të spikaturit që ka pasur kombi ynë ndonjëherë. Por, asgjë më pak se këto nuk është figura e Nolit edhe si njohësi dhe përdoruesi më i mirë i shqipes dhe si kontributor i mendimit

teorik dhe prodhimit edhe në fushën e gjuhës. Dhe pikërisht pse ishte njohësi, krijuesi dhe përdoruesi më i mirë i gjuhës shqipe dhe i shumë gjuhëve të tjera, ai është edhe poeti, oratori, publicisti e përkthyesi brilant i papërsëritshëm edhe nga anglishtja në shqip, si mund të thuhet, i krahasueshëm vetëm me figurën e mikut të tij të ngushtë dhe princit të gjuhës shqipe, Faik Konica.

Noli njihte gati të gjitha gjuhët kryesore të botës dhe është përkthyesi më i madh, më cilësor dhe i paarritshëm. Fan Noli nuk ka përkthyer vetëm libra fetarë, po korifenjtë e botës, ai ka bërë Shekspirin të flasë shqip në përkthimet e tij (Gjeci Vllasi).

Për të qenë në lartësitë e tilla, Fan Nolit nuk i pengonte aspak “gjuha e varfër shqipe”, siç u pengonte kjo gjuhë disa autorëve të tjerë të kohës së tij, apo siç u pengon edhe sot disa krahinarëve shqipja standarde. Përkundrazi, gjuha shqipe i jepte atij forcën si Anteut që i jepte toka. Me fjalën e tij pasionante, me oratorinë e tij brilante, me veprën e tij shumëdimensionale, e ngriti këtë gjuhë si në të shkruar e si në të folur në shkallën më të lartë. Dhe i dha kështu një krah të fortë standardizimit të gjuhës

shqipe me prurje të reja e të mëvetësishme. Përbuzësit e shqipes, që e pandehnin për të varfër e për të padenjë për të folur me këtë gjuhë, Noli do t'i fshikullonte siç dinte vetëm ai: *“Ca autorë shqiptarë thonë se gjuha jonë është aq e varfër sa nuk mund t'i japësh një palë mend as një evgjiti. Po unë them që ata autorë që thonë këtë, s'janë të zotët t'i japin mend evgjinit as me ndonjë tjetër gjuhë. Kurrë mos pandehni se s'kemi autorë të mëdhenj nga shkakun që gjuha nuk na ndih. Autori i madh është i madh edhe memec. Piktori i madh është piktor edhe pa duar. Gruaja e bukur duket një mijë herë më e bukur, po të jetë e veshur me lecka. Dhe idetë e bukura janë një mijë herë më të bukura të mbështjella me fjalët e varfra të popullit, se sa me fjalët e stolisura të filozofëve”.*

Përbuzës të tillë të shqipes kemi edhe sot, madje me radhë të shtuara, të cilët këllasin të huajën përpara vendores dhe krahinoren përpara kombëtares. Veçse sot nuk kemi një Fan Nol që t'i fshikullonte e vetëdijesonte të tillët për ndërudhën që kanë marrë. Në konceptin e Nolit, mund të parafrazonim se faji nuk është te gjuha, as te gjuha standarde, që u pengon shumë disa

krahinarëve e gjysmëpolitikanëve, sepse gjuha ç'të duash ka. Por faji është te përdoruesit e paditur e që përpiqen t'i bien më qafë gjuhës.

Për fjalët e huaja dhe neologjizmat e pakripura

Fan Noli gjuhën nuk e kishte thjesht vetëm dhunti e profesion, por e kishte edhe mision. Ai kishte njohuri të thella filologjike për strukturat të gjuhës, dhe jepte këshilla të drejta për purizmin e puristët. Për puristët e thekur Noli këshillon: *“Puristi që e qëron gjuhën e tij nga fjalët e huaja bën të kundërtën e asaj që dëshiron. E prish gjuhën e nuk e ndreq”.* Ai edhe vetë shumë fjalë turqishte i përdorte me vështrim përbuzës (si p.sh. *memur* për *nëpunës*), por disa të tjera i përdorte sepse ishin ngulitur tashmë në gjuhën shqipe. Në një fjalim të tij në Këshillin Kombëtar, si kryeministër i vendit, për të ilustruar sa më mirë një përkthim të tragjedisë së Hamletit, Noli thotë se do të përdor ca fjalë turqishte që të kuptohen më mirë. E një zëri që thërriste nga salla: *“Shqip, shqip se nuk marrim vesh turqisht!”*, Noli i jepte përgjigjen:

“Fjalët turqishte që kanë hyrë në gjuhë e që i kupton populli anembanë Shqipërisë, janë shqipe më e mirë se neologjizmat e pakripura dhe të pakuptueshme” (Noli 1977: 59). Noli është mjeshtër edhe në formimin e fjalëve të reja. Kështu, krahas fjalës së njohur *qeveri*, ai do të krijojë dhe opozitin *çqeveri*: *Shpejt a vonë populli do t'i kuptojë fyçkat edhe faktet, qeveritë dhe çqeveritë* (Noli 1977: 144). Ja një fjalëformim i ri i Nolit, *çqeveri* – për qeveritë e korruptuara, mashtruese. Sa shumë do t'i shkonte shqipes që kjo fjalë të përdorej edhe për qeveritë dhe qeverisjen e sotme.

Gjuha e jashtëzakonshme e Nolit krahasohet me gjuhën e mjeshtërve më të mëdhenj që krijuan gjuhë: me Naimin, Fishtë, Mjedën, Konicën. Nuk ka sot shkrimtar e letrar që nuk i referohet gjuhës eprorë të Nolit. Dhe ja një referim i tillë i shkrimtarit dhe publicistit Lazër Stani:

“Shqipja, si një ndër gjuhët më të vjetra, u krijua si gjuhë jo nëpërmjet shkrimit letrar (shkrimi i saj është fatkeqësisht i

vonë) po nëpërmjet këtyre fëmijëve “të lindur me gojë” që gjatë mijëra vjetëve shprehën në shqip ndjenjat e tyre, ankthet, vizionet, ëndrrat, shpresat. Dhe arritën të krijojnë një gjuhë të jashtëzakonshme. *Gjuha e Konicës, Naimit, Fishtës, Mjedës, Nolit*, por edhe shkrimtarëve dhe përkthyesve të tjerë shqiptarë të shekullit të njëzetë nuk erdhi si një rastësi dhe as falë gjenisë së tyre gjuhësore. Kjo gjuhë tashmë ishte krijuar prej shekujsh, por ata mundën, falë instinktit të tyre të lindur për fjalën, të shprehën në shqip, duke e çliruar këtë “gjuhë të Perëndisë” me aq sa mundën nga ndotjet dhe barbaritë gjuhësore”.

Fan Noli ka kontribut të ndjeshëm në formimin e shqipes standarde. Me veprën e tij letrare e shkencore, historike e muzikore, me përkthimet e tij, me fjalën e përdorur prej tij, me sintaksën e tij, ai ka vënë edhe themelet e gjuhës letrare a standarde. Shqipja që flasim ne sot është produkt edhe i Fan Nolit në përvijimin e stileve, në krijimin e fjalëve të reja, në përdorimin me qokë e me mjeshtëri të frazave,

frazeologjisë, tekstologjisë, drejtshkrimit.

Për formimin e shqipes së sotme letrare, studiuesi më i mirë gjuhës së Nolit, Fatmir Agalliu, shprehet: “Naimi, Samiu dhe Kristoforidhi janë themelvënësit e gjuhës letrare të përbashkët të kombit tonë dhe Noli është ndër kurorëzuesit kryesorë, në mos më i shquari, të procesit të ngjizjes dhe të ngulitjes së saj këto vitet e fundit... Ndiheja e Nolit në përzgjedhjen e varianteve dhe në ngulitjen e normës është e ndjeshme. Kjo lidhet patjetër edhe me prestigjin e veprave të tij dhe me përhapjen e tyre, sidomos të përkthimeve të Historisë së Skënderbeut dhe të poezive” (Agalliu 1995: 36, 37).

Sikurse pohon gjuhëtari i shquar Agalliu, “*Është gjë e ditur se në krijimin dhe ngulitjen e formës letrare të një gjuhe roli kryesor i takon letërsisë artistike, shkrimtarëve*”. E në këtë rol Noli bëhet *pararendës i drejtshkrimit të sotëm*. Prandaj janë pa bukë kontestimet e tilla që i bëhen standardit sot nga disa inatçorë të çoroditur që kërkojnë krahinën në gjuhën e përbashkët dhe përmbyjsjen e standardit, kinse për të rregulluar padrejtësitë që i qenkan bërë gegërishtes. Për të tillët publicisti dhe regjisor **Xhelil Aliu do të shprehet:**

“Duke bërë titull me të madhe për padrejtësitë e njërit dialekt ndaj tjetrit, apo duke bërë botime me dialektet e dikurshme të gegërishtes, të cilën nuk e kuptojnë lehtë as vetë gegët, mund të kënaqen vetëm ambiciet e disa inatçorëve të çoroditur, por, kurrsesi nuk i vjen ndonjë e mirë gjuhës. Një frymë e tillë ka nisur të japë ndikimet e veta në të folurën e përditshme, sidomos tek një pjesë jo e pakët e kosovarëve, të cilët po prirën nga dialektalizmat e thella, duke i u larguar standardit të gjuhës letrare. Se si mund “t’u hapet rrugë dialekteve, por pa ndëshkuar standardin”, këtë mund ta dinë tamam vetëm autorët e këtyre ideve. Siç thoshte i ndjeri Arbër Xhaferi, “Dialektet i takojnë feudalizmit- standardi letrar, shoqërisë dhe shtetit modern”. Dhe më poshtë vazhdon: “Standarti gjuhësor, mbase i vetmi ind që lidh shqiptarët e të gjitha anëve, tashmë shndërrohet në instrument që do t’i përçajë shqiptarët, jo vetëm në gegë e toskë, por edhe sipas kufijve politikë”. **(Të flasim shqip, por të merremi vesh!, Gazeta “Telegraf”, 28.5.2014).**

Fan Nolin, si një erudit i pashoq i shqipes dhe i shumë gjuhëve të huaja, e ka shqetësuar në mënyrë të vërtetë v e ç a n t e ruajtja e

natyrës së shqipes kur shkruajmë. “Përse nuk vëmë re pak natyrën e shqipes?” – shprehej Noli. Po edhe ne sot, a nuk duhet t’ia bëjmë vetes këtë pyetje, kur shqipen e shkruar kemi kërrusur me gjithfarë ndërtimeve të çoroditura me frymë të huaj jo vetëm në fjalor, por edhe në morfologji, në sintaksë e në frazeologji?

Fan Noli dhe oratoria e tij politike

Fan Noli ishte brilant edhe në mendimin politik dhe në oratori, në ndërtimin e miqësive që na ka lidhur me kohë me Amerikën. Më 4 qershor 1959, në Kishën e Shën Gjergjit në Boston, në 100- vjetorin e Statujës së Lirisë, foli edhe F. Noli me *fannolik*at e tij:

“Amerika është nëna jonë kombëtare. Ajo na ka dhënë mënyrën amerikane të jetesës, demokracinë dhe mundësinë e barazisë. Ajo na ka dhënë katër liritë, d.m.th., lirinë në përgjithësi, lirinë e të mospaturit frikë, lirinë e fjalës dhe lirinë e besimit. Tani që ne jemi mësuar në to, i marrim ato falas. Thjeshtë harrojmë se s’kishim asnjë prej këtyre në atdheun e vjetër dhe se shumë pak vende i gëzojnë ato tani. Kjo është dita e përtëritjes së kujtesës sonë.

Në atdheun e vjetër, gjatë regjimit turk, popullit tonë nuk i lejohet t’i lutej Zotit në gjuhën e vet. Qeveria Turke e konsideronte përdorimin e gjuhës shqipe në shërbesa si subversive dhe peshkopët tanë demode mendonin se Ungjilli i Jezu Krishtit duhej të predikohej në një gjuhë klasike që s’e kuptonte njeri. Por ne besojmë se përdorimi i një gjuhe që kuptohet nga populli pajtohet me traditat më të vjetra të Kishës. Kjo traditë vjen që nga koha e Zotit tonë shpëtimtar, i cili u thoshte Apostujve të tij: “Shkoni ju dhe mësoni gjithë kombet”. Në përputhje me këtë urdhëresë ne i kemi sjellë popullit mesazhin e Zotit, duke shërbyer, predikuar dhe përhapur literaturë në gjuhën që kuptojnë, d.m.th., në shqip. Deri tani kemi botuar 14 libra liturgjike kryesore, 10 prej tyre në gjuhën shqipe dhe 4 në anglisht. Dhe tani brezi i ri gjithashtu mund të ndjekë shërbesat në një gjuhë që e kupton, d.m.th., në anglisht. Këto arritje u bënë të mundura në sajë të lirisë së besimit dhe të shumë mirësive që gëzojmë në këtë demokraci të madhe. Jemi mirënjohës që jetojmë në tokën e njeriut të lirë. Zoti e bekoftë Amerikën!”

Më bukur se kaq, më mirë se kaq, nuk dimë që mund të flitet e të shkruhet për Amerikën që i mbrojt kurdoherë shqiptarët. Për Amerikën që vërtet është Nëna jonë. Nuk dimë se mund të flitet më mirë për përdorimin

dhe mbrojtjen e shqipes edhe në predikimet liturgjike.

Fan Noli bota shqiptare i mbetet borxh gjithnjë. I mbetet borxh edhe gjuha shqipe për fannolikatat e tij të papërsëritshme, po aq sa edhe ai i mbetet borxh gjuhës shqipe që i dha atij forcën dhe krenarinë e të qenit shqiptar.

Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë kur të punojmë për gjuhën “përbashkme shqipe”

Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë jo duke thënë fjalë të mëdha e të përzgjedhura për të në përvjetorë të rastit, siç është edhe ky përvjetor. Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë në radhë të parë edhe duke përdorur korrekt gjuhën e sotme shqipe, në shkollë e në universitet, në administratën shtetërore e publike, në medie, për të cilën punoi aq shumë edhe ky tribun, që me fjalime të zjarra e me shkrime të fuqishme mbrojtë të drejtat e popullit tonë, e mbrojtë këtë gjuhë dhe luftoi për një çështje të madhe kombëtare. Fan Nolin ne sot mund ta respektojmë kur të punojmë për gjuhën e “përbashkme shqipe” (siç thoshin rilindësit) dhe kur të mos punojmë për ristanardizimin e shqipes standarde. Me një fjalë, kur ta kujtojmë Fan Nolin, ne duhet ta kujtojmë edhe gjuhën shqipe, të mos e flasim shqipen si çobanët e Sharrit, siç thoshte një publicist dhe studiues i ideve (Naser Aliu). Ndryshe, ne nuk e kujtojmë Fan Nolin në dimensionet e tij. Por e kujtojmë në varfërinë tonë kulturore e shpirtërore, në të kundërtën e tij. Bëhemi kinse e kujtojmë, sa për demagogji e pozë.

Të rrallë janë ata që e kanë folur dhe e kanë shkruar gjuhën shqipe si Fan Noli. Ja si flet e shkruan ai me një program përpara popullit të Korçës për bujqësinë: “Shqipëria ka pasurinë që duket, e cila është përmbi tokë dhe pasurinë që s’duket, nën tokë. Uroj me gjithë zemër që pasuria nën tokë të jetë më e madhe se sa e kuptojmë, po është marrëzi të kryqëzojmë duart e të presim të gjitha të mirat nga kjo pasuri problematike e të lëmë të pazhvilluar pasurinë parimtare (ja një fjalë e re e Nolit pasuri parimtare = pasuri e parë, themelore, kryesore, për bujqësinë), e cila sikundër na sigurojnë të gjithë ekspertët e huaj, është e mjaftë (ja një ndajfolje e përdorur si mbiemër) për të ushqyer dhjetë herë më tepër ndenjës (ja dhe një neologjizëm tjetër ndenjës për “banor”) se sa ka Shqipëria sot” (Noli 1977: 70). Për punë të pasurive, gjuha e Nolit është

pasuri parimtare (e parë, kryesore) që na jep pamjen e mjeshtrit të madh.

Martin Camaj, në esenë “Mbi funksionin e gjuhës së Nolit dhe Konicës”, heton se “si Noli ashtu dhe Konica në shkrimet e tyre patën parasysh gjithnjë që të kuptoheshin nga gjithë shqiptarët. Këtij qëllimi ia arritën me një përqindje të lartë. Rruga që ata ndoqën qe kjo: ata zgjodhën forma të rrafshita stilistike, u larguan me qëllim nga variantet e shumta të leksikut nëndialektor të formave morfologjike të rralla. Pa ditur ndoshta, iu përmbajtën disa principeve, ndjekja e të cilave çon drejt një njësimi gjuhësor” (Shamku 2013).

Fan Noli lëvroi e mbolli shumë për kulturën shqiptare, e mbi të gjitha mbolli farën e një shqipeje... fannolik. Shqipja në laboratorin e Fan Nolit i ka gjitha lulet dhe shprehësitë e saj. Prandaj veprat e Nolit lexohen me ëndje e me kënaqësi dhe kuptohet lehtë nga të gjithë.

Për njohjen e gjuhës Jean Herbert thoshte:

“Të njohësh një gjuhë është shumë më tepër se një leksik dhe një sintaksë. Duhet njohur të gjitha nivelet e gjuhës, nga më i kulluari te më popullori, duhet njohur veçoritë krahinore, apo sociolektet, me fjalë të tjera të gjitha shmangiet gjuhësore, duhet pasur edhe një kulturë mjaftueshëm të thellë për të zbuluar citimet apo referencat që i bëhen një vepre, një imazhi, një kujtesë kolektive”.

Në këtë kuptim, Noli i njihte të gjitha këto nivele të gjuhës idealisht. Ai krijoi një simfoni të madhe për gjuhën dhe krijoi një shqipe të madhe për nevojat komunikuese të një kombi të vogël. Në farkën krijuese të Nolit shqipja rrjedh shqip në të gjithë dejtë e saj.

Noli, për vlerat njohëse të gjuhës e të kombit, thoshte:

“Lëvizja për të ngritur gjuhën shqipe në shkallë kombëtare nisi në Toskëri” (Agalliu 1999).

Ai këtë e pohonte jo se i përkiste të folurës jugore, por sepse kjo ishte gjendja reale që e kishte arritur shqipja falë punës së çmuar të shkrimtarëve, e ku një kontribut të pallogaritshëm ka dhënë edhe ky kryeshkrimtar e kryeorator Fan S. Noli. Vërtet Fan Noli ka qenë më jetëshkurtri në pushtet ndër ata që kanë qeverisur Shqipërinë, por Fan Noli është ndër ata shkrimtarët që si krijues gjuhe e bahçevan i shqipes, si stilist, mbetet jetëgjatë në letrat shqipe që nuk ia lëshon kurrkujt kryet e vendit.

Është vështirë të thuhet sot se cili ishte roli më i rëndësishëm i Nolit: si letrar, si publicist, si historian, si kishtar, si politikan, si përkthyes, si muzikolog, si poliglott etj. Por, një gjë nuk është vështirë të dihet, që Noli përdori shqipen më të

rrjedhshme që mund të kesh sot.

Fan Nolit do t'i shkonin fjalët që ky vetë i thoshte për Faik Konicën:

“Faik Konica, njohës i mirë i pesëmbëdhjetë gjuhëve të huaja, që e fliste frëngjishten si një francez dhe që e fliste anglishten si një anglez, ishte pa dyshim dhe ustai më i madh i shkrimit të gjuhës shqipe”.

Fan Nolin ne nuk duhet vetëm ta përkujtojmë në raste përvjetorësh, por duhet edhe të mësojmë prej tij se si duhet të punojmë për gjuhën shqipe dhe si ta flasim shqipen shqip.

“Pesë anarkitë” e Nolit dhe anarkitë tona sot

Noli ishte nga ata idealistët e mëdhenj që deshi Shqipërinë ta bënte një vend normal si vendet e tjera të Europës. Në Parlamentin Shqiptar më 1924 do të artikulonte aq saktë ato “Pesë anarkitë tona” (anarkia fetare, anarkia sociale, anarkia morale, anarkia patriotike, anarkia e idealeve), që në thelbin e tyre kanë qenë si të thuash programatike se si të dilet nga kaosi që shqiptarët i kishin krijuar vetes, e që mjerisht këto anarki na riciklohen edhe sot.

Anarkitë tona apo çoroditjet tona nuk janë fashitur pothuajse as pas një shekulli qëkur i artikulonte Noli. Përkundrazi, ato sot janë bërë edhe më të egra, më të anarkishme, me mbishtresime të reja çoroditjeje.

Anarkia fetare: Në emër të fesë a të besimit fetar, sot kemi mbërritur deri aty sa të kontestohen deri dhe figurat e përbotshme e Skënderbeut dhe e Nënë Terezës që bota shqiptare njëherë pati fatin që t’ia jepte njerëzimit. Nuk ka si të mos ta quash anarki kur sekush mund të fyejë idhujt kombëtarë, sekush mund të poshtërojë simbolet, sekush mund të propagandojë radikalizmin fetar.

Anarkia sociale: Nuk ka si të mos ta thuash se klasa jonë politike sot është bërë thellësisht shkatërrimtare, degjenerike, një kope gënjeshtarësh dhe mashtruesish ordinerë, pa kulturë, pa dije, pa sensin e masës për asgjë, moralizues të rremë, banditë, zvatës, me procese të hapura gjyqësore, me dosje krimesh dhe korrupsioni. A i thamë të gjitha? Mbase jo, sepse përsëri të duket sikur fjalët nuk e thonë atë që duhet – vë gishtin në këto plagët tona publicisti Mehmet Kraja.

Anarkia morale: Sot nga fjalët intelektual, profesor, akademik përfundimisht duhet hequr aureolën e idealistit dhe duhet shtuar nuanca të tjera kuptimore, në mënyrë që të

davariten mjegullat e reja e të vjetra dhe faqe botës të dalin të tillë siç janë, njerëz me vese dhe me vlera të dyshimta ose pa to fare, të gënjeshtërt, egoistë dhe servilë deri në neveritje. Ndërsa politikani është bërë sinonim i zvatësit dhe kriminelit, por mbi të gjitha i moralizuesit të rremë dhe vulgar, i cili kudo në botë thotë gënjeshtër me shumicë, por te ne gënjen më së shumti pikërisht atëherë kur thotë se të gjitha i bën për Kosovën dhe popullin e saj (Mehmet Kraja).

Anarkia patriotike: Sa matrapazë e lapërdharë, arrivistë të pandreqshëm, pa shkollë dhe pa dije, natyrisht janë shumë të “brenqosur” me fatin dhe ardhmërinë e kombit dhe e shpallin veten patriotë, vetëm e vetëm për të qenë ata në krye të institucioneve “për të mirën e venit!”.

Anarkia e idealeve: idealet e dikurshme të Nolit e të Rilindasve të tjerë për gjuhën, për kombin, për trashëgiminë tonë kombëtare gjithnjë e më shumë sikur janë shndërruar në ideale të paqena, në një përzierje fatale të vlerave dhe konfuzionit politik, identitar, historik, botëkuptimor, fetar dhe kulturor.

Fan Noli ynë i madh, sikur të ishte i gjallë sot, do t’u shtonte këtyre anarkive edhe disa anarki të tjera, le t’i quajmë produkte “demokratike”:

Anarkia gjuhësore – harxhohet shumë kohë kundër standardit të shqipes, në vend se të harxhohet kohë për mësimin e shqipes. Në Itali, ta zëmë, italishtja ekziston si gjuhë, është pranuar prej të gjithëve megjithëse ka dialekte shumë të largëta nga gjuha që studiohet në shkollë. Asnjërit nuk i vjen në mend që të ndryshohet standardi.

Është një fakt që duket sheshazi që sot ndodhemi në epokën gjuhësore më të çoroditur antistandarde, ku kemi një shqipe të varfër dhe me përplot shkarje nga norma standarde dhe kur askush nuk jep llogari për këtë. Këtë situatë papërgjegjshmërie gjuhësore e kemi në medie, në institucionet dhe në administratën shtetërore e publike, në botimin e literaturës shkollërore dhe universitare, në tekstet mësimore, në revista dhe në edicione të tjera të ndryshme. Çfarëdo teksti dhe botimi universitar që të marrësh në dorë, do të mund të vësh aty papërgjegjshmeri të shumta gjuhësore, që selisin në formimin e lexuesit kulturë të mangët gjuhësore.

“Gjuha shqipe është e kërcënuar nga inercia dhe ca nga çorodia e tranzicionit, si ajo që përfshiu edhe heroin kombëtar Skënderbeun” (Edi Rama), dhe



ndaj kësaj ne nuk duhet të rrimë indiferentë, sepse po rrëshqasim në anarkinë gjuhësore.

Anarkia universitare – krijimi pa fund i universiteteve publike e private në botën shqiptare dhe pa asnjë standard, që po të kërkohej një shprehje më e përshtatshme për të karakterizuar periudhën e viteve të fundit tek ne, më e goditura do të ishte *Universitetomania*. Universitetet që prodhojnë diploma fiktive të shkollës së lartë dikush i ka quajtur dhe “*Huniversitetet*”, pasi këto ishin zyra financiare, që pajisnin “hunjtë” e shoqërisë shqiptare, me diploma fiktive të shkollës së lartë.

Anarkia akademike – shihni çfarë akademish të shkencave kemi sot, Akademi të shkencave pa asnjë shkencëtar, kur gjithkush bëhet akademik me titull të dhuruar, pa asnjë punim apo vepër shkencore për të qenë.

Fan Noli artikuloi i pari “Anarkitë tona”, fshikulloi i pari veset tona. Ne sot duhet ta vlerësojmë dhe rivlerësojmë Nolin kur të punojmë për gjuhën e “përbashkme shqipe”,

kur të identifikojmë problemet tona, kur ta vëmë gishtin në plagët tona, kur të luftojmë anarkitë tona.

Po si mund të dilet nga rrethi vicioz i anarkive tona?

Për të dalë nga kjo gjendje shoqërore e kombëtare që na ka mbërthyer, besojmë dy janë rrugët që i gjejmë të artikuluara në formë anekdotike edhe te populli i Kosovës:

1. “Ta duam dhe ta vlerësojmë njëri-tjetrin sa e urrejtmë”, dhe
2. “Të dimë sa s’dimë”.

Vetëm atëherë do të jemi të shpëtuar. /Marrë nga revista “Akademia”

BIBLIOGRAFIA

Agalliu 1995 = Agalliu, Fatmir, *Fan Noli dhe gjuha letrare e kohës sonë*, “Gjuha jonë” 1-4, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1995.

Agalliu 1999 = Agalliu, Fatmir, *Gjuha e Nolit*, Tiranë 1999.

Noli 1977 = Fan S. Noli, *Topi i lidhur*, Rilindja, Prishtinë, 1977. Shamku 2013 = Shamku Shkreli, Ledi, *Saga e fminisë, energjia gjuhësore e At Zef Pllumit*, Shqiptarja.com, 29.9.2013.

"Pse nuk kemi shpresa të mëdha?"

Nga Carolyn GIARDINA

Filmi i shkurtër i animuar i nominuar për çmimin Oscar "The Boy, the Mole, the Fox and the Horse", i bazuar në librin e ilustruar me të njëjtin emër nga artisti britanik Charlie Mackesy, nuk ishte planifikuar në fillim si një vepër që do të botohej apo si një film.

Gjithçka nisi si një seri vizatimesh në fillim të vitit 2018, të cilat ai i postoi në llogarinë e tij në Instagram (sot me 1.7 milionë ndjekës), ku shfaqeshin 4 personazhet kryesore dhe mendimet e tyre për mirësinë, shpresën, miqësinë dhe guximin.

Për shembull, në një vizatim në Instagram djali pyet: "Cila është gjëja më e guximshme që ke thënë ndonjëherë?" Kali i përgjigjet: "Ndihmë!". Mackesy nisi të postonte më shumë nga vizatimet e tij dhe u prek nga reagime që po merrte. "Të gjithë po diskutonin mbi ndjenjat e tyre, se çfarë ishte e vështirë dhe çfarë shpresonin"- thotë regjisori për THR.

Kjo çoi në botimin e librit në vitin 2019, i ndjekur nga prodhimi i filmit të shkurtër të animuar që nisi në fillim të vitit 2020 gjatë bllokimit të

pandemisë. Mackesy dhe Peter Baynton ishin regjisorë (dhe producentë). Por si të tillë shërbyen edhe Matthew Freud, Cara Speller dhe Bad Robot's, J.J. Abrams dhe Hannah Minghella. Filmi i shkurtër përshkruan djalin dhe miqësinë e pamundur që zhvillohet ndërsa të katër bëhen bashkë për të ndarë mendimet e tyre, dhe teksa djali kërkon shtëpinë e tij. Në një moment mola e pyet djalin se çfarë do të donte të bëhej kur të rritej. Djali i përgjigjet: "I sjellshëm".

Ekipi i animacionit punoi në distancë për shkak të Covid-19, me një synim të përbashkët: krijimin e një pamjeje që të pasqyronte sa më mirë vizatimet në libër, të cilat ishin realizuar më bojë dhe bojëra uji. "Ne donim që t'i bënim ato vizatime të lëviznin, por nga ana tjetër të ruanim frymën e rrjedhshmërisë së bojës dhe vijës dhe trashësinë e ndryshme të vijave"- thotë Mackesy.

Sipas tij pjesa më e vështirë, ishte zhvillimi i personazheve, sidomos i djalit. "Në libër, ai nuk kishte një strukturë të dallueshme të fytyrës. Ishte gjithmonë paksa i errët. Prandaj ai udhëtim zgjati shumë. Unë bëra shumë studime mbi



portretin e tij. Pas studimit të portretit të një djali, e hodha të në letër një mëngjes dhe të gjithë më thanë "Ky është!".

Por Mackesy e pranon se druhej se mos ishte shumë përshkruar. "Më pëlqente ideja që ai ishte paksa i errët, në mënyrë që njerëzit të mund ta projektonin veten apo që ai mund të ishte kushdo. Por e dija që duhet të jemi shumë më specifik dhe të themi: "Ky është djali, ja si duket. Këto janë emocionet dhe ndaj do

të lidhemi me të!"-thotë ai.

Projekti u bë më i rëndësishëm pasi njerëzit u bënë më të izoluar gjatë pandemisë së Covid-19. "Ndonjëherë posta ime elektronike kishte 50.000 e-maile (në përgjigje të vizatimeve dhe librit të tij), dhe shumë prej tyre ishin shumë të dhimbshme. Shumë prej tyre po më tregonin të vërtetën e jetesës së tyre me Covid-19, qofshin shkolla, spitale apo individë. Ishte shumë emocionuese kur i lexoja"-

kujton Mackesy. Ishte dëshira e tij që kur filmi të dilte në kinema, të shkaktoje disa nga ndjenjat e përshkruara në histori, si shpresa ose të kuptuarit se është në normale të kërkosh ndihmë.

"Unë shpresoja që kur të mbaronte filmi, njerëzit do të ndiheshin të prekur, me shpresë dhe më të lidhur me njëri-tjetrin. Dhe të ndihen më pak të vetmuar dhe më rehat me veten. Pse të mos kenë shpresa të mëdha?". /bota.al

Fabio Testi po jeton "Dolce Vita"-n e tij

Regjisori italian Vittorio De Sica triumfoi në Festivalin e Filmit të Berlinit, kur kryevepra e tij e vitit 1971 "Kopshti i Finzi-Continis" fitoi Ariun e Artë dhe një vit më vonë çmimin Oscar si filmi më i mirë i huaj. Po ashtu, ai film i dha aktori të famshëm italian Fabio Testi një "Glob të Artë" si aktori protagonist.

Gjysmë shekulli më vonë, me mbi 100 role në karrierën e tij, Testi mbetet aktiv dhe luan në rolet që nxjerrin në pah pamjen e tij të jashtëm ende mahnitëse dhe oreksin e madh për skenën. Po ashtu ai është shumë i pranishëm në tabloidet italiane. Një kërkim i shpejtë në Google mbi projektet aktuale filmike dhe televizive të Testit, dominohet nga historitë e aventurave romantike aktuale dhe të dikurshme me gra nga e gjithë bota. Testi mbush këtë vit 82 vjeç, dhe i është përkushtuar dy pasioneve të tjera përtej romancave të tij dashurore: bujqësisë dhe aktrimit.

"Kam bërë 102 filma me emrin tim"- thotë Testi për Variety nga veranda e pasme e fermës së tij në Liqenin Garda, Itali. Ai vë në dukje se karriera ishte më pak e planifikuar dhe më shumë e pashmangshme. Ofertat për të luajtur në filma ishin të njëpasnjëshme.

Testi kujton se ishte me fat që jetoi në Romë gjatë rilindjes artistike të qytetit në vitet 1970-1980, duke u bërë një element i kulturës pop në qytet, dhe duke pushtuar tituj e mediave me rolet e tij në film por edhe lidhjeve me aktore si Edwige Fenech, Ursula Andress, Charlotte Rampling etj.

"Ajo kohë ishte një moment i mirë për kinemanë italiane. Unë isha me fat që isha atje në momentin e duhur"- thotë aktori. Gjatë asaj që ai e quan si "kriza e parë e kinemasë" në fundin e viteve 1990, Testi e ktheu vëmendjen e tij tek teatri, me një rol në përshtatjen skenike të filmit të vitit 1954 fitues të çmimit Oscar me regjinë e Federico Felini "La Strada" (Rruga).

"Të gjithë më kishin parë në kinematografi. Ndërsa në teatër mund të bëj çfarë të dua. Sigurisht, në një film është e vështirë të ndryshosh idenë e publikut. Ndërsa në skenën e teatrit është më e lehtë"- thekson ai.

Fillimisht në pronësinë e gjyshit të tij, toka e fermës e tij në Italinë e Veriut doli në shitje gjatë kulmeve të karrierës së tij filmike dhe Testi e bleu atë. Një kasje jo shumë e zakonitë për kohën doli të ishte profetike, pasi Testi mbolli kivi.



Gjatë udhëtimeve të tij në Los Anxhelos ai kishte vizituar disa ferma me kivi, dhe ishte kurioz nëse mund të mbillte ato në tokën e vendlindjes së tij. Aventura e Testit si fermer pati një sukses, që ishte me i gjerë sesa investimi i tij fillestar në një sipërfaqe prej 10 hektarësh. "Italia u bë prodhuesi i parë i kivit në Evropë. Rasti im nisi si një hobi dhe më vonë u bë një biznes i mirë"- shprehet aktori. "Ferma e ndihmoi tim atë të qëndronte me këmbë në tokë, të ishte në kontakt me realitetin,

me njerëzit e vërtetë, jetën reale"- shton djali i tij, Fabio Testi Jr.

Aktori u detyrua të ndryshojë sërish kurs, kur biznesi i kivit nuk ecte më si në fillim. Ai mbolli disa hektarë me ullinj dhe pemë të tjera që lejojnë rritjen e tartufit, duke zotëruar kështu fermën e parë të tartufit në zonën e tij. Fabio Testi ka në duar disa projekte filmike dhe televizive, por si gjithmonë ai i kushton kohë këshillimit dhe mësimi të brezit të ardhshëm të aktorëve.

Ai thotë se ka mësuar nga "më të mirët" e botës së kinemasë, dhe është i gatshëm që t'ia përcjellë dijet dhe përvojën talenteve të rinj që punojnë në industrinë e argëtimit. "Kinemaja është e bukur. Ajo është dashuria dhe jeta ime. Kur shoh një aktor apo këngëtar të ri, ata ndryshojnë, lëvizin, për t'iu përshtatur rrethanave. Por nëse je vërtet artist, nuk ke nevojë të ndryshosh veten. S'ke nevojë të jesh ndryshe nga ai që je. Mund të jesh aktor, këngëtar apo artist, por ji vetvetja"- thekson Testi.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Gjysmëfinalja e Kupës: Llapi - Gjilani dhe Prishtina - Vushtrria

PRISHTINË, 21 MARS - Në praninë e Komisionit të Garave, të përfaqësuesve të klubeve dhe medieve, të martën është bërë tërheqja e shortit për ndeshjet gjysmëfinale të Kupës së Kosovës. Skuadra fituese e këtij trofeu në edicionin e kaluar, Llapi, në këtë fazë do të përballet me skuadrën e

Gjilanit. Ky rreth i garave zhvillohet me sistem vajtje-ardhje. Ndeshja e parë zhvillohet në stadiumin “Zahir Pajaziti”, kurse ajo kthyesë në stadiumin me bari sintetik në Gjilan. Çifti tjetër gjysmëfinal është ai ndërmjet Prishtinës dhe Vushtrrisë. Përballja e parë e këtyre dy skuadrave

zhvillohet në Vushtrri, kurse ajo e kthimit në Prishtinë. Ndeshjet luhen më 5 prill, kurse ato të kthimit më 19 prill.

ÇIFTET GJYSMËFINALE:

Vushtrria - Prishtina
Llapi - Gjilani



Ademi: Ta jetësojmë ëndrrën e kualifikimit në Kampionatin Evropian

PRISHTINË, 21 MARS - Në prag të fillimit të fushatës kualifikuese për “Euro 2024”, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka vizituar futbollistët e Përfaqësueses A që në ditën e tyre të parë të grumbullimit për t’u dhënë mbështetjen e rezervë të tij dhe të të gjithë federatës në rrugëtimin drejt kualifikimit në Kampionatin Evropian.

Në fjalimin e mbajtur para futbollistëve, Ademi shfaqti besimin në këtë grup të lojtarëve duke thënë se me kualitetin që kanë ata, duhet ta synojnë vendin e parë në grup. “Pothuajse të gjithë ju tashmë jeni në situata shumë stabile në klubet tuaja, keni kontrata

të favorshme, shumica prej jush keni minuta të konsiderueshme në ekipet ku luani, prandaj kërkoj nga ju që gjatë vitit 2023 prioritetin ta keni te Kosova dhe që së bashku ta jetësojmë ëndrrën që e kemi që shumë kohë, e që është kualifikimi në Kampionatin Evropian. Ju tashmë keni edhe përvojën sepse jeni në një moshë të pjekur dhe keni rastin ideal për ta arritur këtë qëllim që do të sjellë lumturi e krenari të pakrahasueshme të të gjithë popullit ynë. Keni kualitet, keni përvojë, keni nivel. Ajo çfarë duhet të bëni është të angazhoheni maksimalisht, të mbështeteni në forcën e



grupit, t’i tejkaloji interesat e ngushta personale dhe të fokusoheni te sukcesi ynë i përbashkët”, ka thënë Ademi. FFK-ja dhe presidenti Ademi po vazhdojnë të angazhohen

për ta ngritur çdoherë e më shumë nivelin organizativ të Përfaqësueses A dhe në këtë aspekt sot ekipit i është bashkuar edhe një nutricionist anglez, që është pjesë e klubit

të Arsenalit dhe që do të jetë me Kombëtaren tonë gjatë ditëve në vijim për ta përmirësuar edhe më tej kujdesin e të ushqyerit të futbollistëve tanë.

Khaka: Origjina ime, gjaku im është Kosova

CYRIH, 21 MARS - Kapiteni i Kombëtares së Zvicrës, Granit Xhaka, është deklaruar për çështjen e dyshtetësisë dhe për mentalitetin shqiptar në familjen e tij. Mesfushori i Arsenalit është pjesë e dokumentarit të Kombëtares së Zvicrës, i quajtur “The Pressure Game”, ndërsa në pjesën e tij të katërt, të titulluar “Presioni i gjakut”, ishte radha për futbollistin e Kosovës. Regjisorët e dokumentarit e kanë vizituar kapitenin e “helvetikëve” në shtëpinë e tij



në Londër, ndërsa kanë folur edhe me gruan e tij, Leonitën.

Xhaka ka folur për çështjen e dyshtetësisë dhe për

mentalitetin shqiptar në familjen e tij, shkruan mediumi zviceran “20min”. “Unë jam krenar që luaj për Zvicrën, por origjina ime, gjaku im, është Kosova”, ka thënë Xhaka. Ai foli edhe për imazhin e tij në publik dhe për marrëdhëniet e tij me mediet. “Nuk e kuptoj se përse shkruhen gjithmonë vetëm gjëra negative”, ka pyetur futbollisti i Kosovës. Natyrisht, e pashmangshme ishte tema e ndeshjes me Serbinë në Kupën e Botës. “E kam

vendosur qëllimin tim që të qëndroj pozitiv në fushë. Më pas, nëse ndodh diçka e keqe, unë vendos të largohem dhe t’i shmangem problemit”, e përshkruan Xhaka punën e tij brenda fushës së blertë. Në të mirë dhe në të keqe, Xhaka i ka zhvilluar plot 111 ndeshje me “Nati”, ndërsa është treguar një lider i vërtetë. “Nuk është e lehtë të luash në këtë nivel për dhjetë vjet. Por, dikush duhet ta bënte këtë i pari...”, ka përfunduar Xhaka në fund të dokumentarit.

Zenelaj, MVP i javës në Superligë

PRIZREN, 21 MARS - Në fundjavë u zhvillua xhiroja e 26 e Prince Caffe Superligës. KB Ponte Prizreni shënoi fitore të rëndësishme, duke mundur Rahovecin në garë për një vend në “play-off”. Te prizrenasit më i miri ishte Urim Zenelaj me dyshifrorë të dyfishtë prej 20 pikëve e 12

kërcimeve, një asistim, një top të vjedhur dhe katër bllokada. Zenelaj kishte indeksin 32, apo më të lartën e kësaj xhiroje, duke u shpallur MVP. Paraqitje të mirë bëri edhe Meriton Ismaili me 20 pikë, gjashtë kërcime dhe dy asistime. Derbin e kësaj jave e fitoi Peja, që mundi Trepçën në

“Minatori”. Te verdhezinjtë u dalluan Brad Waldow me 11 pikë, 20 kërcime dhe dy asistime, si dhe Arti Hajdari me 17 pikë, një kërcim dhe një asistim. Golden Eagle Ylli regjistroi fitore ndaj Vëllaznimit në udhëtim, ku te therandasit më i miri ishte Chris Harris me 12 pikë dhe 19 kërcime.



Rashica: Dua të bëhem një prej legjendave të Galatasarayt

STAMBOLL, 21 MARS -

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, është i huazuar te Galatasaray nga Norwich City, por futbollisti "dardan" nuk po mendon të rikthehet në Angli. Ish-

lojtari i Vushtrrisë po shpreson që klubi nga Stambolli ta blejë kartonin e tij, shkruan mediumi turk "fotomac". Madje Rashica e sheh veten duke luajtur në Turqi edhe për një kohë të

gjatë dhe të lërë gjurmë në klubin "verdhekuq". "Dua të qëndroj në Galatasaray për disa vjet dhe të bëhem një prej legjendave të klubit", ka thënë Rashica, i cili ka shënuar në ndeshje me

Konyan. Rashica është duke e kaluar një periudhë të shkëlqyeshme në Galatasaray dhe është bërë lojtar mjaft i rëndësishëm pas një fillimi të vështirë të cilin e pati.



Golden State fiton me Curry-Thompson, zhgënjejnë Dallasi e Philadelphia

HOUSTON, 21 MARS - Skuadra kampione e Golden States rikthehet te fitorja në NBA, duke mposhtur me rezultat 121-108 Houstonin. Dysjha Curry - Thompson, protagonistë në fushë, bashku realizuan 59 pikë. Zhgënjën Dallasi, që u mund me shifrat 112-108 nga Memphisi, ndeshje ku për vendësit dallimin e bëri Jaren Jackson me 28 pikë. Pas kohës shtesë fitoi Chicago, që mundi me shifrat 109-105 Philadelphian, duke prishur planet për kreun e



renditjes në Lindje. LaVine me 26 pikë e DeRozan me 25 pikë ishin liderë në fushë për Bulls, duke i bërë të pavlefshme 37 pikët e 16 reboundet e Joel Embiidit për vendësit. Fitore të rëndësishme për një vend në "play-off" në Perëndim korri ekipi i Utah

Jazzit, që mundi me rezultat 128-120 Sacramenton. Tetë lojtarë të Jazzit realizuan mbi 10 pikë. Minnesota mundi me rezultat 140-134 New Yorkun në një ndeshje spektakolare, sfidë ku Price realizoi 35 pikë, ndërsa 57 pikët e Randles për njujorkezët mbetën për statistikë.

REZULTATET

Charlotte - Indiana	115-109
Philadelphia - Chicago	105-109
New York - Minnesota	134-140
Houston - Golden State	108-121
Memphis - Dallas	112-108
Utah Jazz - Sacramento	128-120

Taliyah Hopkins, MVP e xhiros së fundit në Superligë

PRISHTINË, 21 MARS - 20 ndeshje, 20 fitore është bilanci i Bashkimit këtë edicion. Për fitoren e xhiros së 20 në ndeshje me Vëllaznimin me shifra 69:101 u dallua amerikania Taliyah Hopkins me 31 pikë, nëntë kërcime dhe gjashtë asistime. Hopkins ishte e saktë 3/6 për tri pikë, si dhe 8/10 për dy pikë, ndërsa kishe bilanc 6/9 nga gjuajtjet e lira. Fitores i shtoi kontribut edhe qendra Aulona Muhadri me 17 pikë, 12 kërcime dhe dy asistime. Prishtina ishte nikoqire e United Basketball, ndeshje kjo e cila u mbyll me rezultat 70:42. Kapitenia Djellza Deka pati performancën më të mirë, e cila shënoi 15 pikë, gjashtë kërcime dhe dy asistime dhe u ndihmua nga lojtarja e natyralizuar Enxhi Xhanaj me nëntë pikë, 14 kërcime dhe tri asistime. Penza arriti fitore në udhëtim ndaj Trepçës me rezultat 58:71. Për



fitoren e 12 më e dalluara ishte Jeta Zeka, e cila kontribuoi me 21 pikë, 10 kërcime dhe pesë asistime.

SHKURT

Eliminohet Prishtina

KB Sigal Prishtina është eliminuar nga garat e Ligës ENBL. Prishtinasit në çerekfinale të kësaj gare janë mundur nga skuadra polake King Szczecin me shifrat 85:78, ndërsa në ndeshjen e parë takimi kishte përfunduar 64:64. Kështu prishtinasit u eliminuan nga kjo garë, në edicionin e parë që morën pjesë në këtë ligë. Ndeshja në Poloni ishte interesante. Pjesa e parë përfundoi 41:42, por çereku i tretë ishte vendimtar, duke përfunduar 23:12 për vendësit, që fituan në fund 85:78.

Messi është favorit për 'Topin e Artë'

Portali autoritar "Goal" ka publikuar versionin më të fundit të renditjes së tij të pretendentëve kryesorë për "Topin e Artë" në vitin 2023. Ylli i PSG-së, Lionel Messi, i cili u bë kampion bote në Argjentinë në dhjetor, mbetet favoriti kryesor. Messi në fund të vitit tashmë mund ta marrë Topin e Artë në karrierën e tij. Nëse shikoni më tej vlerësimin e portalit "Goal", atëherë në top tre ka pasur ndryshime. Erling Haaland e zhvendosi Kylian Mbappe në vendin e tretë dhe përfundoi i dyti. Kujtojmë se vitin e kaluar "Topin e Artë" e fitoi me të drejtë sulmuesi i Real Madridit, Karim Benzema.

Kane në shitje, 'Spurs'-i kërkon 114 milionë euro

Nga Tottenham Hotspuri pritet të largohet në fund të këtij sezoni Harry Kane. Është thuhet se pamundur që "bombieri" anglez të vijojë në kushte, pa pasur mundësi të luftojë për trofe, apo të jetë protagonist në Ligën e Kampioneve. Sipas "Times", drejtuesit e "gjelave" i kanë vendosur një çmim kapitenit, 114 milionë euro. Pavarësisht se Kane ka një kontratë deri më 2024, pra futet në vitin që i skadon kontrata, rrezikon shumë në këtë pikë, presidenti Levy nuk ka ndër mend të bëjë skonto për kartonin e tij. Në garë për t'i siguruar shërbimet e Kanes janë Manchester Unitedi dhe Bayern Muncheni.

Hodgsoni rikthehet në Crystal Palace

Ish-trajneri i Anglisë, Roy Hodgson, është rremëruar trajner i Crystal Palaces deri në fund të sezonit. Patrick Vieira, i cili zëvendësoi Hodgsonin në "Selhurst Park" në korrik të vitit 2021, u shkarkua nga Palace të premten e kaluar pas një ecurie prej 12-ndeshjesh pa fitore në të gjitha garat. Hodgson, 75-vjeçar, drejtoi Watfordin nga janari deri në maj 2022, duke u larguar pasi ata ranë në Championship. "Është një privilegj të më kërkohet të kthehem në klub, i cili gjithmonë ka qenë kaq shumë i dashur për mua. Objektivi ynë i vetëm tani është të fillojmë të fitojmë ndeshje dhe t'i marrim pikët e nevojshme për ta siguruar qëndrimin tonë në Premierligë", ka thënë Hodgson.

Verstappen: Botëror i mërzitshëm me vetëm dy pilotë dhe një makinë që dominon

Sezoni 2023 në Formula 1 pritet të jetë një monolog i Red Bullit, që në dy garat e para të zhvilluara ka dominuar me dy pilotët e saj. Në Bahrein fitoi Max Verstappen, duke lënë

pas shokun e tij të skuadrës Sergio Perez, ndërsa në Arabinë Saudite ndodhi e kundërta. Në të dyja garat në vendin e tretë është renditur Fernando Alonso me Aston

Martin, që ka mbërritur në finish me rreth 15 sekonda vonesë. Ferrari e Mercedesi akoma më pas, çka tregon se këto dy skuadra që deri vjet duelonin për fitore, këtë vit

janë si breshka. "Po bëhet një botëror i mërzitshëm, me vetëm dy pilotë që duelojnë për fitore. Ky është një problem. Nëse do të vazhdojë kështu deri në fund, atëherë

kërkoj nga skuadra që të më japë një makinë të besueshme, që të mos ketë probleme, siç ndodhi këtë fundjavë", ka thënë Verstappen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “TRKS Company” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811959595 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “TRKS Company” L.L.C.Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811959595 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “TRKS Company” L.L.C.with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811959595 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Doctor Physio” – SH.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811560699 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Doctor Physio” - d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811560699 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Doctor Physio” - L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811560699, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erxhan Morina shpall te pavlefshme 4 dëftesat certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Bujar Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Andu Ademaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VI shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Blend Morina nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Asllan Berisha" Rogovë.

- Fatlume Curri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Kadire Haziraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl III, IV të sh "Kadri Kusari" Biologji.

- Maklidone Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Normale "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

